



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Biologji-Kimi”

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”,
Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Anila Hoda

2. Prof. Dr. Magdalena Cara

Dhjetor/ 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Për Programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi", ofruar nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë,

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Biologji - Kimisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Biologji - Kimi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 352, datë 12.05.2010.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMAS Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16/3
18	Numri i studentëve:	75 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor "Biologji Kimi" ofruar nga Departamenti i Biologji Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane (FSHNH), Universiteti "Fan Noli", Korçë është hapur me vendim Nr. 352, datë 12. 05. 2010:

Në nivel kombëtar nuk është i vetmi program studimi i këtij profili. Ai është hartuar dhe organizuar në përputhje me misionin dhe vizionin e UNIKO, duke synuar të përgatisë specialistë të aftë për zgjidhjen e problemeve të arsimimit, prodhimit, mjedisit në rajonin e Korcës.

GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit pranë ASCAL në formë elektronike dhe të printuar, si dhe evidentuar gjatë vizitës në institucion konkludon se Programi i studimit është ndërtuar dhe realizohet mbi një përvojë të mirë institucionale, të vlerave akademike dhe ato të kërkimit shkencor.

Stafi drejtues dhe pedagogët përbëhen nga personeli akademik dhe ndihmës, që punojnë me kohë të plotë dhe të përfshirë në aktivitetin kërkimor shkencor që garanton vijimësinë afatgjatë të burimeve akademike, por që duhet të mbështetet fuqimisht nga Institucionit për promovimin në grada dhe tituj akademikë.

Programi i studimit është i ndërtuar mbi bazën e kritereve dhe standarteve referuar tipologjisë së lëndëve, si dhe ngarkesës së orëve dhe krediteve me një shpërndarje korekte dhe uniforme të tyre. Gjithë veprimtaria e Departamentit dhe realizimi i programit mësimor bazohet në rregullore dhe dokumentacion të përditësuar, transparent dhe të bërë publik për të gjithë të interesuarit.

Departamenti shqyrton dhe vlerëson në mënyrë periodike kurikulën e programit të studimit dhe bën ndryshimet e nevojshme në përputhje me aktet ligjore, Statutin dhe rregulloret e institucionit. Këto ndryshime janë të nevojshme për ta formuar studentin me kompetenca dhe aftësi në përputhje me kërkesat e tregut të punës, të cilat cipas studimeve të tërthorta të kryera, nuk janë të pakta në sektorin e arsimit publik dhe privat, por edhe në subjekteve private të sektorit të industrisë dhe ushqimit.

GVJ konfirmon se klasat auditoret janë të mirëpajisur me mjete audivizive, internet në të gjitha ambjentet, infrastruktura laboratorike është bashkëkohore dhe të gjitha janë në funksion të programit të studimit, për të siguruar realizimin e plotë dhe cilësor të tij.

Sistemet e sigurimit të cilësisë, sistemet e informacionit, të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës janë funksionale dhe plotësojnë kushtet optimale në shërbim të një programi që plotëson standartet dhe kriteret e përcaktuara.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Raporti i vlerësimit të jashtëm për programin e ciklit të parë Bachelor në “Biologji-Kimi”, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është hartuar nga grupi i punës i përbërë nga dy pedagogë të Universitetit Bujqësor të Tiranës të profileve Biologji dhe Kimi. Raporti është përgatitur pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentave të vëna në dispozicion në sistemin e ASCAL, nga GVB, si edhe vizitës dy ditore pranë Departamentit Biologji - Kimi. Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm. Në hartimin e raportit, grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të qarta duke vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, nivelin dhe performancën e personeli akademik, vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion etj. Pavarësisht punës tepër voluminoze, procesi i ndërtimit të raportit rezultoi tepër i vlefshëm. Ky proces shërbeu jo vetëm për njohjen më nga afër të çështjeve të ndryshme, por edhe për rritjen e mëtejshme të cilësisë së fushave të këtij programi studimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmbledh informacione të marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces vlerësimi. Vlerësimet për çdo standart dhe fushë synojnë të paraqesë figurën sa më reale, në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Anila Hoda dhe Prof. Dr. Magdalena Cara. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Xhiliola Bixheku, Koordinatore Teknike e ASCAL.

Grupi u njoh dhe shqyrtoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me agjendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me datat 12 dhe 13 tetor 2020.

Më 16.12.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 56/40 Prot., datë 16.12.2020 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjete sistemit AMS dhe me shkresë zyrtarë Nr. 2055/2 Prot., datë 18.12.2020, institucioni kthen përgjigje

për këtë Draft – RVJ. Draft – RVJ kthehet në Raport Final. GVJ u njoh me komentet dhe jep pwrngjigjen si vijon:

Komenti i GVB: në lidhje me Standardin IV. 5, kriteri 6 është sugjeruar: *Plani mësimor, si dhe syllabuset mund të ofrohen në dy gjuhë, (shqip dhe anglisht), për të lehtësuar studentët e huaj që dëshirojnë të kryejnë lëvizje të tipit "Credit Mobility", GVB saktësojnë se syllabset në gjuhë të huaj ndodhen në department dhe ngarkohet çdo vit në sistemin elektronik ESSE 3.*

GVJ merr në konsideratë komentin dhe dokumentacionin e dërguar nga IAL dhe bën ndryshimin përkatës në RVJ.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Biologji - Kimi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare. Ai është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit në këtë fushë.</p> <p>Vëmë në dukje se; Institucioni ofron programe studimi që jo vetëm nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por edhe që janë në përputhje me to, zhvillimet e vendit dhe nevojat e tregut të punës sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”.</p> <p>Mbështetur në listën kombëtare të profesioneve, kompetencat e formimit të studentëve të programit të studimit Biologji - Kimi, janë përfshirë në rregulloren e programit të studimit duke synuar gjithashtu edhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare (<i>Shtojca 2.5. Rregullorja e programit të studimit bachelor në biologji kimi</i>). Informacioni i vënë në dispozicion për GVJ e mbështet totalisht këtë.</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga intervistat e realizuara gjatë ditëve të vizitës, nga dokumentat e vëna në dispozicion në sistem, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) thekson se ky program studimi “Biologji - Kimi”, synon plotësisht ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Universiteti “Fan S. Noli” si IAL, synon të ofrojë vlera të larta profesionalizmi, qytetarie si edhe vlera akademike e kulturore kombëtare, vlerësuar me tituj nga institucionet më të larta të vendit.</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin e arsimit të lartë, si dhe me politikën udhëheqëse të Universitetit, të reflektuar në statutin e UNIKO (<i>Shtojca 1.1. Statuti i UNIKO.pdf</i>), të miratuar me Urdhërin Nr. 56, datë 08.02.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi përkon me strategjitë e aplikuara për zhvillimin ekonomik të rajonit dhe të vendit.</p>

<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm thekson faktin që pavarësisht se në nivel kombëtar nuk është i vetmi program studimi i këtij profili, në UNIKO ky program është relativisht i ri.</p> <p>Stafi i departamentit ka hartuar një kurrikul në përputhje me kapacitetet e brëndëshme, ekperiencat më të mira kombëtare dhe rajonale si dhe në nxitje të zhvillimit ekonomik lokal të rajonit të Korcës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

<p>Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga informacioni i vënë në dispozicion, intervistat me personelin e departamentit por edhe më gjerë na rezultoi se programi i studimit “Bachelor” në “Biologji-Kimi” përgatit specialistë për profesione në fushën e mësuesisë, etj., me qëllim që të fuqizojë pozitën konkurruese në Shqipëri si dhe të përmirësojë cilësinë nëpërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor. Kjo është në përputhje edhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli”. Programi synon zgjidhjen e problemeve të arsimit, prodhimit, mjedisit në rajonin e Korcës.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Mbështetur në planin strategjik (<i>Shtojca 1.3: Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2016 – 2020</i>), në Statutin (<i>Shtojca 1.1: Statuti i Universitetit Fan S. Noli</i>), <i>Miraturar me Urdhërin Nr. 56, datë 08.02.2018, të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë</i>) dhe rregulloren e studimeve universitare të UNIKO (<i>Shtojca 1.2. Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO</i>) si dhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane (<i>Shtojca 2.2_Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore Fakultetit të Shkencave të Natyrore dhe Shkencave Humane, Miraturar me Vendimin Nr. 511, datë 30.09.2019 të Senatit Akademik të Universitetit Fan S, Noli Korçë</i>), janë të përcaktuar qartë të gjitha drejtimit prioritar akademike, si i tillë është dhe programi Bsc. në “Biologji - Kimi”; ndër të tjera ky program synon të përgatisë specialistë të kualifikuar të aftë të përballen me sfidat e kohës për Biologji – Kimi, mësimdhënës të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale në fushën e biologji – kimisë, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t’u kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për</p>




	<p>nxënësit.</p> <p>Njësitë përgjegjëse kanë përgjegjësi në realizimin e këtij programi studimi, koordinojnë me efikasitet progresin e tyre me Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit (<i>Shtojca 1.3. Plani strategjik uniko 2016-2020.pdf</i>) sidhe me rregulloret specifike të tyre (<i>Shtojca 2.2 & 2.3. Rregullorja e njësisë kryesore.pdf & Rregullorja e njësisë bazë.pdf</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Nga vizitat në Departamentin e Biologji - Kimisë, takimet me GVB, personelin akademik të departamentit, si dhe kontrollin e dokumentave të ngarkuara në sistem, nga GVJ u vu re; Struktura e programeve të studimit, lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet në mbarimin e tij, emërtimi i programit të studimit, kodi i programit të studimit, orientimi i programit të studimit, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, kreditet, metodat e vlerësimit, kriteret e pranimit në programet e studimit, rezultatet e të nxënit, komponentët mësimorë të programit të studimit, rregulloret, plani mësimor, diploma dhe suplementi, frekuentimi, fatura financiare etj., janë në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Programi është ndërtuar dhe organizuar mbi bazë e Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të Universitetit “Fan S. Noli” dhe Statutin e Universitetit. (<i>Shtojcat 1.1 & 1.2</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

<p>Standardi I.3</p> <p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar Rregullores së Programit (<i>Shtojca 2.5</i>), por edhe nga intervistat gjatë ditëve të vizitës, rezulton se në këtë programi studimi objektivat e mësimdhënies janë të përshkruara qartë dhe përputhja është e plotë. Në fokus, vërehet të jetë përcjellja e njohurive të reja nëpërmjet mësimdhënies dhe standardeve të larta profesionale. Në lidhje me formimin e studentëve synohet pajisja e tyre me njohuritë që çojnë drejt studimeve më të thelluara.</p> <p><i>Sipas Rregullores së Programit të studimit (Shtojca 2.5) Pika 5 Objektivat formuese, disa nga objektivat specifike për këtë program janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përgatisë mësimdhënës të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale në fushën e Biologji – kimisë, cilësi të larta morale dhe shoqërore për tu kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për

	<p>nxënësit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të pajisë studentët me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehi praktike për arritjen e standarteve të larta në mësimdhënie në fushat e Biologjisë dhe Kimisë shkollat ku do të punojnë, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grup moshave, përparësitë e arsimit në vendin tone dhe rolin e mësuesit si profesionistë në një kontekst social nëndryshim. - Të përgatisë mësimdhënës, si njerëz të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet. - Të përgatitë mësimdhënës të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë, për të ndihmuar në zhvillimin e tyre, për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve. - Të nxisë studentët për të kryer punë kërkimore – shkencore dhe eksperimentale duke shfrytëzuar burime të informacionit (literaturë bashkëkohore, site interneti, periodikë, manual didaktike, etj.), si dhe laboratorët e biologjisë dhe kimisë, infrastrukturë bashkëkohore që disponon Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane.
<p>Kriteri 2.</p> <p>Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga takimet me GVB, stafin akademik por edhe më gjerë dhe sikurse pohohet në RVB; ndonëse nuk ka një studim të posaçëm për tregun e punës në fushën e kimisë dhe të biologjisë, nevojat e sektorit të arsimit për profesionistë të diplomuar në fushën e kimisë dhe të biologjisë janë të njohura nëpërmjet disa studimeve të tërthorta për tregun e punës, pra të dhëna dytësore. GVB i është referuar disa studimeve të tregut të punës që paraqesin nevojat për punësim pranë drejtorive arsimore rajonale, e cila lidhet me mundësinë për të vazhduar studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” dhe të punojë si mësues biologjie dhe kimie në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme publike dhe jopublike. Kjo mundësi për punësim mbështetet në numrin e madh të shkollave 9–vjeçare, të mesme, të mesme profesionale, si publike dhe private që përfshihen në rajonin juglindor të Shqipërisë, ku përfshihen një sërë bashkish, si ajo e Korçës, Maliqit, Pustecit, Pogradecit, Kolonjës, Devollit, Prrenjasit e deri Librazhdit. (<i>Shtojca 3.12. Studim tregu pune ba bk.pdf</i>).</p> <p>Studimet e vëna në dispozicion kanë të bëjnë me interesin e madh që kohët e fundit kanë paraqitur edhe subjekte private industriale dhe ushqimore për specialistë dhe trajnues i problematikave që lidhen me fushat e kimisë e biologjisë, madje kërkesat janë parashtruar që në fazat e të qënies student.</p> <p>Programi përmbush nevojat e tregut të punës për specialistë të fushës së biologjisë dhe të kimisë. Në kuadër edhe të politikave</p>




	<p>kombëtare për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka qenë i nevojshëm shtimi i numrit të specialistëve me njohuri biologjike dhe kimike të lidhur me zhvillimin ekonomik në fushën e mjedisit, industrisë përpunuese ushqimore, teknologjitë bashkëkohore dhe shëndetin human.</p> <p>Në analizën e punës së departamentit (<i>Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njesisë Bazë_Shtojca 3.8</i>) jepen të dhënat mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe vazhdimin e ciklit të dytë. Sa më sipër listohen edhe në statistikat e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, pranë Rektoratit. (<i>Shtojca 3.12</i>).</p> <p>GVJ gjithashtu, zhvilloi një vizitë në Fabrikën e “Birra Korca” ku studentët zhvillonin praktikat profesionale, si dhe në laborator ku ishin të punësuar një studente që kish kryer studimet master dhe një studente që vazhdonte studimet në departamentin Biologji - Kimi.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se ky program studimi, pavarësisht që është i ri, ai ka shfrytëzuar maksimalisht përvojën e programeve të ngjashme brenda vendit duke krijuar një qëndrueshmëri, traditë dhe vazhdimësi.</p> <p>Struktura e kurrikulës së programit, rezultatet dhe objektivat e të nxënit për studentët të dhëna në modulet, janë në funksion dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme të Programit.</p> <p>Sa më sipër rezulton se ky program garanton plotësisht formimin teorik dhe praktik të specialistëve me aftësi të larta në fushën përkatëse, si një domosdoshmëri themelore e tregut në ditët e sotme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njesisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti i Korçës u krijua në dt. 7 janar 1992, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor të Korçës (1971-1992), me tre fakultete: i Bujqësisë, i Mësuesisë dhe i Ekonomikut. Si universitet publik, ai në vite ka krijuar traditë të nivelit të lartë të trajnimit të personelit me përvojë brenda dhe jashtë vendit. UNIKO ka një personel të aftë profesional dhe të përgatitur; (<i>Shtojca 4.4</i>). <i>Tabela e Personelit akademik të angazhuar në programin e studimit [për tre vite]</i>. Programi i studimit mbështetet nga stafi akademik i vetë Departamentit, si dhe të departamenteve të tjera. Nga vlerësimi i</p>




	dokumentacionit dhe vizitave në institucion rezulton se ekzistojnë të gjitha kapacitetet si në infrastrukturë, ashtu dhe në burime njerëzore, përvojë akademike dhe struktura ndihmëse universitare mjaft efektive, gjë që rrit cilësinë e këtij programi studimi. Personeli akademik është i kualifikuar (<i>Shtojca 4.1</i>), dhe një pjesë e mirë e tij, me një përvojë shumëvjeçare në këtë fushë studimore dhe aplikative, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme e programit të studimit i përket shkencave natyrore; specifikisht biologjia dhe kimia. Ky program studimi përputhet me atë që ofron njësia kryesore; Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNSHH) sipas (<i>Shtojca 2.2</i>). Vetë Departamenti i Biologji- Kimisë duke ju referuar (<i>Shtojcës 4.3</i>) ofron programe studimi në ciklin e parë “Bachelor” në “Biologji–Kimi” me kohë të plotë të organizuar në disiplina dhe module, vlerësuar me kredite (sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane), në total 180 ECTS. Çdo vit akademik në sistemin e studimeve me kohë të plotë ka 60 ECTS reflektuar në (<i>Shtojcën 2.5</i>).			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Për këtë program studimi është miratuar një rregullore e posaçme, e cila është në koherencë të plotë me rregulloren e njësisë bazë. Në Rregulloren e Departamentit (<i>Shtojca 2.3</i>), vihet re se përcaktohet edhe fusha e programeve të studimit. Njësia bazë që ofron programin e studimit, “Bachelor” në “Biologji-Kimi”. Ajo ka një personel të kualifikuar që zhvillon kërkim shkencor në fushën e biologjisë dhe të kimisë. Stafi akademik ka përvojë kryesisht në mësimdhënie (mesatarisht nga 5 deri 25 vjet përvojë pune pedagogjike) sipas (<i>Shtojcës 4.1</i>) dhe relativisht më pak në kërkim shkencor. Vihet re që stafi ka kualifikimet përkatëse sipas moduleve që mbulon.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit	Nga vlerësimi na rezulton se Departamenti Biologji – Kimi menaxhon dhe drejton me efektivitet këtë program studimi. Mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit bëhet në formë

<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>të koordinuar nga instancat drejtuese të UNIKOs.</p> <p>Gjithashtu u vërejt një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit, në mënyrë që të lehtësohet i gjithë aktiviteti i studentëve brenda institucionit gjatë të gjitha viteve të studimit, dhe të rritet efektiviteti i këtij program studimi.</p> <p>Nga takimet monitoruese u vu re qartë se edhe brenda departamentit, i gjithë personeli akademik dhe ndihmës/akademik bën përpjekjet maksimale për të përmbushur me përpikmëri detyrimet profesionale dhe detyrat e caktuara në dobi të rritjes së cilësisë së këtij program studimi.</p> <p>Për të vlerësuar performancën dhe arritjen e objektivave të programit të studimit, institucioni kryen analiza periodike/vjetore në nivel fakulteti, departamenti dhe për njësi të tjera të sigurimit të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, por edhe nga vizitat në vend, vihet re që janë të dokumentuara qartë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione vendase apo të huaja, të sektorit publik apo privat, gjë që paraqet një rëndësi të madhe për shkëmbim përvojash, lidhjes me tregun e punës, rritjes së mundësisë për punësim, kualifikimeve të mëtejshme të studentëve nëpërmjet praktikave profesionale etj. (<i>Shtojca 2.10_Marrëveshje Bashkëpunimi në Mbështetje të Praktikave Profesionale</i>).</p> <p>Sipas dokumentacionit në dispozicion evidentohen; Marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me Drejtorinë e Ujësjetës - Kanalizimeve Korçë, Bashkinë Korçë, Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Korçë, Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Korçë, Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Korçë, fabrikën “Birra Korça”, si dhe me një sërë biznesesh të tjera në fushën e përpunimit dhe prodhimit të ushqimeve etj., të cilat shfrytëzohen për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale. Lista e subjekteve të tjera pranë të cilave organizohen periodikisht praktikat jepet në (<i>Shtojcën 3.5</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shfletimi i dokumentacionit dhe nga diskutimet me personelin e departamentit si dhe nga RVB vihet re që nuk ka një traditë raportimi analitik të përfitimeve nga marrëveshjet, veçanërisht kur ato nuk janë të trupëzuara. Gjithësesi, në rastin e kontributeve në aktivitete të përbashkëta me institucione të tjera ato janë të pasqyrohen në dokumentat përkatëse. (<i>Shtojcën 3.6</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Konstatohet që praktikat mësimore dhe profesionale të studentëve realizohen në bazë të një marrëveshje institucionale ndërmjet Universitetit dhe institucionit pritës së studentit për ushtrimin e praktikës mësimore. Këto marrëveshje janë finalizuar nëpërmjet nënshkrimit të kontratave përaktëse.</p>

	<p>UNIKO ka marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë (<i>Shtojca 2.10; 3.5</i>). Në kuadër të këtyre marrëveshjeve studentët e programit të studimit Biologji-Kimi realizojnë praktika mësimore dhe profesionale pranë shkollave të arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm dhe të lartë në qarkun e Korçës.</p> <p>Konstatohet se gjatë tri viteve të studimit bachelor, studentët realizojnë praktikën në institucione të sektorit privat me të cilat institucioni ka kryer marrëveshje paraprake.</p> <p><i>Por nuk dokumentohet mjaft qartë mënyra e mbikëqyrjes nga vetë institucioni mbi frekuentimin e rregullt të ditëve të praktikës, efektivitetin e tyre, etj.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Në këtë aspekt Departamenti i Biologji-Kimisë në bashkëpunim me qendrën e formimit të vazhduar në UNIKO, ofron dy module të akredituara për trajnimin e mësuesve.</p> <p>Përkatësisht: “<i>Rëndësia e eksperimentit në mësimdhënien e lëndës së kimit në AML</i>” dhe “<i>Risite didaktike dhe eksperimentale në biologjinë qelizore</i>”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit organizohet në lëndë e module (<i>Shtojca 2.5</i>) <i>Rregullorja e programit të studimit bachelor në Biologji - Kimi</i> , ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe në total 180 kredite. Gjatë procedurës së vlerësimit GVJ konstaton se Departamenti i Biologji - Kimisë (DBK) është i organizuar në dy grupe mësimore, me bazë lëndore, atë të biologjisë dhe të kimit për të përmbushur, detyrimet e programit

	të studimit. Stafi i departamentit është i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në hartimin e syllabuseve dhe në realizimin e këtij programi studimi. Sipas përcaktimeve të rregullores së njësisë bazë (Shtojca 2.3) departamenti ka caktuar drejtuesin e grupit me bazë lëndore të biologjisë në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit. Koordinatori është miratuar nga dekani i FSHNH (Shtojca 2.11).
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.	Si program studimi i ciklit të parë, ky ofron njohuri dhe kompetenca bazë të domosdoshme për vijimin e studimeve të ciklit II. Ai është i harmonizuar mjaft mirë me të dyja programet e ciklit të dytë të DBK. Nga shqyrtimi i (Shtojca 2.5_Pjesa e kurrikulës), rezulton se në 4 semestrat e parë ofrohen lëndë themelore të formimit bazë dhe që përfshijnë një spektër të gjerë njohurish të domosdoshme për lëndët profesionale që synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Nisur nga sa theksohet në RVB, si dhe nga dokumentacioni në dispozicion rezulton se; Programi i “Biologji - Kimisë” ofron një profil profesional të dallueshëm dhe të spikatur me disiplina që japin kompetenca dhe mjeshteri të lidhura me kërkesat e tregut të punës. Vetë kurrikula e programit të studimit “Biologji-Kimi” është hartuar në përputhje me nevojat e specialiteteve dhe e përafuar me programe homologe brenda dhe jashtë vendit. Vihet re një ekuilibër i mirë ndërmjet moduleve në kategorinë bazë, asaj karakterizuese, integruese dhe plotësuese (Shtojca 2.7). Programi i studimit të ciklit të parë në “Biologji-Kimi” bën pjesë në ciklin e studimeve bazë të studentëve që synojnë në përgjithësi transmetimin e koncepteve bazë të formimit të studentëve me njohuri nga fusha e biologjisë dhe të kimisë. Programet e studimeve synojnë t’u ofrojnë studentëve kurrikula, metodologji, literaturë dhe infrastrukturë të tillë që të jenë konkurrues në tregun e punës dhe të mund të ndjekin programet progresive të studimit në çdo universitet brenda e jashtë vendit.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programet e studimit janë hartuar në përputhje me qëllimin e institucionit, duke synuar përgatitjen e specialistëve të ardhshëm në fushën e biologjisë e kimisë, si dhe për t’iu dhënë mundësi për studime të mëtejshme në programet e ciklit të dytë “Master profesional” dhe/ose “Master i Shkencave”. Gjithashtu këto programe mundësojnë përfshirjen e menjëhershme në tregun e punës që ka lidhje me fusha të mjedisit, të industrisë përpunuese ushqimore, institucionet shëndetësore, etj.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha	Nga shqyrtimi i hollësishëm i dokumentacionit rezulton se ky program studimi, përsa i përket strukturës dhe elementëve përbërës

<p>elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>të tij, është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore etj.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Sipas rregullores të programit të studimit, mbështetur edhe në VKM 41 (2018), paraqiten grupet e klasifikimit të veprimtarive formuese të pasqyruara në program. Nga shqyrtimi i kurrikulës, syllabuseve etj., rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar sasinë vjetore prej 60 kreditesh. Duke parë rregulloren e programit të studimit theksojmë që; në planin mësimor janë përcaktuar në mënyrë të detajuar leksionet, seminarët, laboratorët, ushtrimet (sipas specifikës së çdo lënde), orët e praktikës profesionale, si dhe orët për tezën e diplomës, me ngarkesën javore dhe semestrale (brenda dhe jashtë auditorit), si dhe ECTS për çdo lëndë (<i>Shtojca 2.7</i>).</p> <p>Konkludojmë se plani mësimor sipas (<i>Shtojca 2.7</i>) si dhe aktivitetet e tjera formuese, janë në përputhje me informacionin që mund të asimilohet dhe praktikohet nga studentët. Vërehet një ekuilibër ndërmjet orëve teorike dhe praktike dhe është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin. Sipas (<i>Shtojca 2.7</i>) dhe bisedave me stafin e departamentit rezulton që studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, ku ajo përfshihet në planet mësimore dhe strukturën e vitit akademik. Modulet janë të përcaktuara sipas veprimtarisë formuese dhe kjo është e shënuar në syllabusin e modulit. Mbi këtë bazë është bërë edhe përcaktimi i krediteve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (FSHNH), pranë UNIKOs është njësia kryesore e strukturuar për të ofruar programe studimi, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015. Bazuar në dokumentat e Strukturës organizative, Statutit</p>

	<p>dhe rregullores së UNIKOs, si edhe mbi kërkesat ligjore pranohet se njësia kryesore; fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. Njësia bazë përgjegjëse për programin “Biologji-Kimi” është Departamenti i “Biologji-Kimisë”. Ky një prej departamenteve më të reja të FSHNH. Në zbatim të detyrimeve ligjore me vendim Rektorati (<i>Shtojca 3.2</i>) ka filluar procesin e akreditimit dhe vlerësimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, si edhe takimeve gjatë vizitës në institucion, rezultoi se njësia përgjegjëse ka caktuar në rolin e koordinatorit të programit, përgjegjës aktual të Departamentit. Nga takimet me GVB përgjegjësja aktuale e Departamentit si dhe ish - përgjegjësi dukeshin të rakorduar në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e programit si edhe të praktikave profesionale. Sa më sipër ishte në përputhje me objektivat e programit si dhe garantonte qëndrueshmërinë e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Organizimi i njësisë kryesore në departamente, stafet akademike përkatëse për secilin departament përmbushin detyrimet ligjore. DBK është i organizuar në dy grupe mësimore, përkatësisht Biologji dhe Kimi, dhe ka staf të kualifikuar sipas kriterëve ligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Nga dokumentat e vëna në dispozicion si dhe nga bisedat dhe intervistat me stafin akademik por edhe me studentë bachelor dhe master të DBK rezultoi se Departamenti ka një personel akademik të kualifikuar, që punon me përkushtim si në mësimdhënie ashtu edhe në seancat laboratorike. (<i>Shtojca 4.1</i>) <i>Tabela e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.</i></p> <p>Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore konstatohet se DBK përbëhet nga 9 anëtarë personel akademik në total. Nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK. Konkretisht kualifikimet e stafit të këtij departamenti janë: PAE: 1 PhD Jashtë vendit (UK), 4 Dr dhe 2 MSc, kurse stafi PAK përbëhet nga 2 MSc.</p> <p>Gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në procesin mësimor ka edhe stafi ndihmësakademik që asiston gjatë procesit, veçanërisht në orët e praktikave dhe laboratorit. Në funksion të moduleve dhe laboratoreve janë në dispozicion të programit edhe personeli ndihmësakademik i departamenteve të tjera.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Rezulton e dokumentuar qartë se DBM përmbush detyrimet ligjore përsa i përket organizimit në grup lëndë, struktura akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik. Sipas (<i>Shtojca 2.2</i>) rezulton që kjo njësi përmbush të gjithë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore duke ushtruar</p>

	kompetenca të plotë mbi mbarëvajtjen e mësimin dhe kërkimit, siç përcaktohet edhe në rregulloren e studimeve të (FSHNN) dhe të programit “Biologji-Kimi”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ndërtohen bazuar në gjithë informacionin mbi programin e studimit, stafin akademik dhe strukturat e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Programi i studimit në “Biologji-Kimi” administrohet nga departamenti i “Biologji-Kimisë” dhe mbështetet në Rregulloren e Studimeve të UNIKO (<i>Shtojca 1.2</i>), Rregulloren e Programit të Studimit “Biologji-Kimi” (<i>Shtojca 2.5</i>), kurrikulën dhe planin mësimor sipas (<i>Shtojca 2.7</i>). Sa më sipër është mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM 41 (e ndryshuar).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Sipas rregullore së programit të studimit (<i>Shtojca 2.5</i>), veprimtaritë formuese të programit të studimit përfshijnë: lëndë bazë; lëndë karakterizuese; lëndë ndërdisiplinore/integruese; lëndë plotësuese; detyrime përmbyllëse, dhe provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës. Nga shqyrtimi i detajuar i kurrikulës dhe syllabuseve, nuk paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator).
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Sipas dokumentacionit (<i>Shtojca 2.5 & 2.7</i>) shihet që programi është i organizuar në 23 lëndë dhe 36 module. Ngarkesa në kredite e çdonjërit nga modulet merr në konsideratë volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore. Për ato module që kanë një ngarkesë më të lartë të orëve laboratorike apo praktikave mësimore, vërehet që ky numër është vendosur më i lartë. Bazuar në rregulloren e programit të studimit rezulton se (<i>Shtojca 2.5</i>), ndarja e lëndëve është si vijon <ul style="list-style-type: none"> • lëndët bazë kanë të parashikuar 6 module që përbëjnë 17% të krediteve; • lëndët karakterizuese kanë të parashikuar 17 module që përbëjnë 54% të krediteve; • lëndët ndërdisiplinore kanë të parashikuar 6 module që

	<p>përbëjnë 15% të krediteve;</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndët plotësuese kanë të parashikuar 7 module që përbëjnë 11% të krediteve; • detyrimet përmbyllëse 3% të krediteve. (<i>Shtojca 2.7</i>). <p>Ndarja e lëndëve është bazuar në në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM 41 (i ndryshuar).</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjeve të plota të syllabuseve për programin e studimit “Biologji-Kimi” në (<i>Shtojcën 2.5</i>) vihet re që aty përmbahej; plani mësimor, informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Sikurse edhe na u konfirmua nga takimet kjo dosje është në përditësim të vazhdueshëm kur pedagogët kërkojnë të përmirësojnë pjesë të programit apo literatuës së përdorur. Eventualisht, syllabusi miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe zëvendëson syllabusin e mëparshëm në dosje. Ajo që vihet re si mangësi është që shpesh literatura gjëndet vetëm si tituj dhe autorë por mungojnë vitet e publikimit. Po kështu tekstet dhe literatura pothuajse i përkasin Fakultetit të Shkencave Natyrore të Tiranës; gjë për të cilën GVB na sqaroi se kanë marrë miratime paraprake për përdorimin e tyre. Disa nga modulet kanë dispenca apo cikle leksionesh të përgatitura nga stafi akademik i departamentit. Sa më sipër doli në dukje gjatë takimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Sipas rregullores së DBK, ai përcakton strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit “Biologji-Kimi”. Këtu përfshihet edhe rregullimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Sikurse doli gjatë takimeve, gjithashtu edhe është theksuar në RVB; Departamenti “Biologji-Kimi” administron një faqe në rrjetin social Facebook, e cila përdoret periodikisht para periudhës së regjistrimeve për promovimin dhe informimin e maturantëve mbi programin e studimit. Njëherazi përdoret gjatë vitit akademik jo vetëm për informimin e studentëve në mënyrë dinamike, por edhe për pasqyrimin e gjithë aktivitetit të departamentit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në (<i>Shtojcën 2.5</i>) jepen informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, si dhe një pasqyrim i hollësishëm për sa i takon përmbajtjes së praktikave, seminarëve apo orëve dhe temave të laboratorit, si dhe literaturat përkatëse.</p> <p>Po ashtu jepen të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara</p>




	mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM 41 (i ndryshuar) si dhe syllabuset e detajuara për secilën lëndë.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga dokumentacioni si dhe takimi me stafin akademik të DBK u vu re që Programi i studimit “Biologji-Kimi” është përditësuar sipas formatit të VKM 41 (i ndryshar) dhe pasqyron të gjithë komponentët mësimorë. Stafi akademik thotë që; përmbajtja e programeve të studimit është ndryshuar me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe është miratuar në departamentin “Biologji-Kimi” dhe në Senatën e UNIKO e theksuar kjo edhe në (<i>Shtojca 2.12 Procedura e ndryshimit të planit mësimor.pdf</i>). Nuk ka ndonjë dokumentacioni të detajuar për ndryshimin e programeve si dhe impaktet e pritshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Duke iu referuar Ligjit 80/2015 “Për arsimin e Lartë në RSH”, neni 70 pika 4, programet e studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë organizohen në tre cikle të njëpasnjëshëm, i parë, i dytë dhe i tretë, sipas nivelit 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi Bachelor në “Biologji-Kimi”, i përket kornizës 6 të kualifikimeve. Referuar <i>Rregullores së programit të studimit</i> , ky program studimi është i organizuar në tre vite akademike/6 semestra, me 60 kredite në një vit akademik dhe 180 kredite në total. Konstatohet se është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Tek programi i studimit i emërtuar “Biologji-Kimi”; përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe e praktikave mundësojnë njohuri bashkëkohore dhe atraktive për studentët, ato janë të organizuara sipas objektivave të formimit dhe mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe punësimin. Nga GVJ konstatohet se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike si dhe të mësimdhënies mjaft të larta, elementë të rëndësishëm për t’u përballur më lehtë me tregun e punës pas diplomimit të tyre.

	<p>Sa më sipër u pohua nga studentët Bachelor dhe viti i parë Master Profesional që morrën pjesë në takimet me GVJ.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi i “Biologji-Kimisë”, përmban mjaftueshëm module karakterizuese dhe integrale që formojnë shprehinë bazë në fushën e Biologjisë dhe Kimisë me njohuri të mjaftueshme për specialitetet e këtyre fushave.</p> <p><i>GVJ konstaton se titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë “Profesor” ashtu sikurse janë kërkesat ligjore.</i> Gjatë takimit me shefin e departamentit dhe stafin akademik na u tha se pezullimi i dhënies së titujve dhe gradave ka penalizuar shumë stafin akademik i cili mund ti ketë plotësuar të gjitha detyrimet/kriteret e kërkuara.</p> <p>Në lidhje me atë çfarë është shprehur në standardin II.3, në mënyrë që i gjithë informacioni që shkon tek publiku i gjerë të jetë sa më i qartë dhe i kompletuar, <i>sugjerohet që në syllabuset e lëndëve të pasqyrohet jo vetëm tematika e leksioneve, por dhe temat e detajuara të laboratorëve dhe/ose praktikave mësimore. Rrjedhimisht është e domosdoshme të paraqitet e detajuar qartë ngarkesa e laboratorëve/praktikave javore dhe semestrave.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre si dhe detaje të tjera janë përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>Shtojca 2.5</i>), modulet janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar midis veprimtarive formuese, me një raport që përputhet me atë të Shtojcës 1 të VKM 41 (i ndryshuar) dt. 24.1.2018. Po ashtu edhe shpërndarja e moduleve që bëjnë pjesë në fushën e biologjisë me atë të kimisë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se të gjitha lëndët janë në përputhje me profilin e programit, dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këto dy fusha studimi. Nga infrastruktura, kapacitetet e laboratorëve, bisedat me stafin etj, rezultojnë qartë se raporti teori/praktikë është mëse i kënaqshëm për finalizimin me sukses të programit, sa më sipër duhet të reflektohet më mirë në dokumentacion.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raportet midis formimit teorik dhe praktik vihen re të materializuara sidomos në disa module të biologjisë, kimive të ndryshme; e përgjithshme dhe inorganike, organike, analitike, etj si dhe mikrobiologjisë, imunologjisë etj., duke synuar të mundësojnë arritjen e objektivave formues. Informacionet në këto module janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e biologjisë dhe atë të kimisë.</p> <p>Për të identifikuar mundësitë që ndërtimi i programit lejon për mobilitete janë në dispozicion disa dokumenta, transferime dhe</p>




	punësim në përfundim të studimeve.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Sipas RVB dhe bisedave me stafin e departamentit; Gjatë këtyre viteve është konstatuar një përpjekje intensive dhe e vazhdueshme e stafit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë shprehje e kompetenca që iu duhen për të ardhmen. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5-10 viteve të fundit (<i>Shtojca 2.5</i>). Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar që literatura ka nevojë për rifreskim si dhe evidentime më të sakta të saj (vitet referente) në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Kjo vihet re në disa lëndë dhe ju theksua GVB si dhe stafit akademik gjatë takimeve.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Duke ju referuar DVV, është e qartë se ky program studimi ka një përmbajtje të tillë të lëndëve/moduleve që garanton formimin e specialistëve me aftësi dhe kompetenca të kënaqshme për këtë nivel studimi.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga studimi i dosjeve të programeve shihet që ato synojnë t'u ofrojnë studentëve kurrikula, metodologji, literaturë dhe infrastrukturë të tillë që të jenë konkurrues në tregun e punës dhe të mund të ndjekin programet progresive të studimit në çdo universitet brenda e jashtë vendit. Programet synojnë rritjen e kompetencave shkencore e profesionale të studentëve, formimin e etikës, njohjen e legjislacionit dhe përfitim të shprehive praktike për të qenë të aftë në kryerjen e detyrave të ndryshme në fushën e njohjes teorike dhe të aplikacioneve të biologjisë dhe kimisë. Ky program BA pasohet nga 2 programe MSc si dhe Master profesional të dyja këto më atraktante për kërkesat e tregut të punësimit si dhe për studime të ciklit të tretë.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga RVB dhe biseda me GVB për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit departamenti "Biologji-Kimi" ka lidhur marrëveshje dhe bërë konsultime me strukturat e arsimit në lidhje me kurrikulat e reja të cilat janë pasqyruar në programin e studimeve. Sipas (<i>Shtojcës 2.10</i>), anëtarët e departamentit konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve ku studentët kryejnë dhe praktika të lëndëve të ndryshme dhe më pas i reflektojnë ato në mësimet teorike dhe praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli <i>akademik</i></p> <p>me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i DBK dhe ai jashtë departamentit që angazhohet në realizimin e programit BA të studimit, përmbush kriteret sipas ligjit, lidhur me rolin që realizojnë në mësimdhënie dhe aktivitetet kërkimore e shkencore duke u bazuar në tituj e grada. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë ka një staf akademik dhe kërkimor me kohë të plotë të kualifikuar. Personeli i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe të Shkencave Humane (FSHNNH) që angazhohet kryesisht në programin e studimit “Biologji-Kimi” ka një shkallë të mjaftueshme kualifikimi (<i>Shtojca 2.9; 4.1; 4.8</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie e këtij programi ka kompetencë dhe përvojë në mësimdhënie, por edhe angazhim në këshillim tekniko-profesional për donatorë, biznese private apo agjenci publike (<i>Shtojca 2.9</i>). Stafi i angazhuar në programe studimit Bsc në “Biologji-Kimi” është i përbërë nga 19 anëtarë personel akademik PAE dhe PAK. Konkretisht kualifikimet e stafit të këtij programi janë: PAE (16): 1 Prof; 1 Prof. As. Dr., 11 Dr/PhD dhe 3 MSc dhe stafi PAK (3): 1 Dr. dhe 2 MSc.</p> <p>Nga dukumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se 93% e ngarkesës mësimore mbulohe nga stafi PAE dhe 7% nga ai PAK. Ngarkesa në orë e stafit bazohej në Udhëzimin 29 të MASR. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është:</p> <ul style="list-style-type: none">a) Kategoria Profesor: 140 orëb) Kategoria Lektore: 165 orëc) Asistent-Lektore 195 orë <p>Çdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përlllogaritet sipas koeficienteve dhe paguhet e plotë nga IAL-të. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulohe edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë. (udhezimi i MASR). Nr. i orëve luhetet nga</p> <p>Edhe nr i lëndëve që mbulojnë pedagogët bazohet në këtë udhëzim, stafi nuk mbulon më shumë se 3 lëndë.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e</p>	<p>Referuar CV të stafit akademik dhe lëndëve që ata mbuloj në këtë program studimi GVJ konstaton se fusha ekspertizës së stafit</p>

<p>përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet me lëndët që ata mbulojnë. Vihet re një numër i kufizuar në tituj akademikë; është vetëm një Prof.Dr. dhe një Prof.As Dr dhe këta janë jashtë DBK. Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në vend rezulton se, një pjesë e këtij stafi ka patur përvoja pune në agjenci shtetërore që lidhen me fushën e kontrollit të sigurisë ushqimore. Kjo i mundëson të transferojnë sa më mirë njohuritë dhe konceptet tek studentët dhe t'i përshtasin metodat e mësimdhënies në funksion të programit të studimit “Bachelor” në “Biologji-Kimi”.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UNIKO por edhe FSHNSHH ka disa marrëveshje bashkëpunimi që duket të jenë ndihmuese për praktikat profesionale, temat e diplomave (megjithëse të kufizuara) si dhe orë të tjera praktike. Konkretisht marrëveshjet janë me: Drejtorinë Rajonale të Arsimit, Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizimeve Korçë; Njësinë Vendore tëKujdesit Shëndetësor, Korçë, Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Korçë që përbëhen nga personel me kualifikim profesional të lartë, por edhe subjekte private që kanë shkallë të lartë ekspertize profesionale dhe që garantojnë ndjekjen e studentëve gjatë praktikave.</p> <p>Po në funksion të formimit profesional të studentëve janë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me fabrikën “Birra Korça”, etj. siç është referuar në përmbushjen e Standardit I.5 (<i>Shtojca 2.10</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Personeli ndihmës akademik i angazhuar është i specializuar në fushën përkatëse dhe me përvojë. Angazhimi i tij në procesin mësimor, veçanërisht punët laboratorike dhe praktikat, është bërë i detyrueshëm me urdhrin e Rektorit të UNIKO për rolin e personelit ndihmësakademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>UNIKO ka një udhëzues (<i>Shtojca 2.18</i>) të nivelit bazë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përshtatur këto sipas fushës së studimit. Këtu përfshihen: <i>Google Clasroom, Google Meet, eduMEET, Moodle</i>. Gjithashtu, departamenti i Biologji–Kimisë, në Rregulloren e programit të studimit (<i>Shtojca 2.5</i>), përcakton metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sa më sipër janë të përshkruara në Statut dhe Rregullore.</p> <p>Nga takimet me stafin e departamentit doli në pah se këtë vit mësimor metodat e mësimdhënies me anën e programeve të ndryshme kompjuterike ishte mjete i shfrytëzuar për shkak të kushteve të krijuara nga pandemia (Covid 19). GVJ ka kontrolluar materialet e vëna në dispozicion si dhe linket e platformave të mësimdhënies, është vënë re që pavarësisht se <i>Moodle</i> ekziston si ikonë, përmendet edhe në RVB si metodë mësimdhënie ajo nuk funksionon.</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>Nga vizita në institucion gjatë takimit me studentët, u konstatua si kjo realizohet në mënyrë të matshme vetëm nëpërmjet pyetësorit anketues (<i>Shtojca 3.13</i>).</p> <p>Rezulton se të dhënat e gjeneruara i transmetohen përgjegjësit të departamentit dhe analizohen gjatë mbledhjeve me stafin.</p> <p>Konstatohet se dekanati realizon monitorime të faktit nëse zhvillohet apo jo në mënyrë të rregullt procesi mësimor, por jo vlerësim cilësie të procesit të mësimdhënies, gjë që realizohet nga vetë departamenti me mbarimin e çdo moduli. Nga anketimi dhe raporti i hartuar pas tij, vihet re që anketat përshijnë pyetje ku kërkohen opinione e vlerësime për performancën akademike të çdo pedagogu, mënyrën e realizimit të mësimdhënies, mënyrën e komunikimit me studentët, qartësinë e transmetimit të koncepteve, termave, mënyrën e formën e vlerësimit, etj. Nëpërmjet anketimeve synohet sigurimi i përfshirjes në një shkallë sa më të lartë të studentëve në mësimnxënie dhe formimi i tyre profesional sa më i lartë.</p> <p>Nga biseda me studentët si dhe nga raporti i anketimeve (<i>Shtojca 3.13</i>) rezulton që; anketimet realizohen si rregull në përfundim të çdo semestri akademik dhe rezultatet e tyre bëhen publike pas</p>

	<p>përfundimit të procesit të anketimit.</p> <p>DBK mbështetur në “Paktin për Universitetin” pretendon që anketimi online në shkallë kombëtare i lançuar nga ASCAL do të jetë edhe më efikas dhe me pjesmarrje më të madhe.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV, si dhe vizitave në institucion, rezultoi se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, e të vlerësimit të dijeve. Kjo realizohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit (Shtojca 3.13), i cili synon tërheqjen e opinioneve të studentëve lidhur me procesin e mësimdhënies dhe çdo problematikë tjetër lidhur me to. Nëpërmjet anketimeve (Shtojca 3.13) të ndryshme që realizohen, bëhet monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe performancës për gjithë stafin akademik. Anketat përshijnë pyetje ku kërkohen opinione e vlerësime për performancën akademike të çdo pedagogu, mënyrën e realizimit të mësimdhënies, mënyrën e komunikimit me studentët, qartësinë e transmetimit të koncepteve, termave, mënyrën e formën e vlerësimit etj. Nëpërmjet anketimeve synohet sigurimi i përfshirjes në një shkallë sa më të lartë i studentëve në mësimnxënie dhe formimi i tyre profesional sa më i lartë.</p> <p>Ajo që u konstatua gjatë vizitës ishte se janë 2 pyetsorë që janë deklaruar në dokumentacionet në dispozicion; njëri ju përket moduleve dhe realizohet pas mbarimit të semestrit dhe tjetri realizohet në nivel Fakulteti.</p> <p>Për pyetsorin e dytë u vu re se janë të njëjtat pyetje si për nivelin Bachelor ashtu edhe për atë master profesional. Nga diskutimet u konkludua se ato duhet të jenë të diferencuara.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga intervistat me personelin akademik rezultoi se ata njoftohen në mënyrë periodike mbi rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Ky njoftim realizohet nga përgjegjësi i departamentit gjatë mbledhjeve me stafin dhe aty diskutohet dhe mbi këto rezultate në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies, nisur nga shqetësimet e evidentuara.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Plotësimi i pyetsorëve realizohet dhe administrohet nga përgjegjësi i departamentit dhe sekretarja e departamentit, gjatë orëve të leksioneve në javën e 14 dhe 15 të semestrit të parë dhe të dytë në çdo vit akademik. Rezultatet përpunohen dhe mbi bazën e tyre hartohen raportet me shifrat konkrete si dhe me grafikë. Këto rezultate janë pjesë përbërëse e analizës vjetore të DBK si dhe e Fakultetit dhe UNIKO. Analiza vjetore përfshin rezultatet e arritura në mësimdhënie e mësimnxënie, jep shembuj pozitivë, nxjerr në pah problemet dhe parashikon masat për përmirësimin e situatës në të ardhmen. Këto të dhëna përfshihen</p>




	në raportin e analizës vjetore të UNIKO (<i>Shtojca 2.20</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Gjatë takimit me stafin akademik të këtij program studimi u diskutua se përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies përbën një ndër prioritetet kryesore të departamentit. GVJ konstaton se në këtë program studimi praktikohen elementë të shumtë të veprimtarisë mësimore; të gjitha lëndët e modulet përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, praktika mësimore, laboratorë, detyra dhe projekte kursi, praktika profesionale, etj. Edhe gjatë intervistave me studentët dëshmohej qartë që janë të informuar që në fillim të semestrit; gjatë zhvillimit të lëndës aplikohen praktikisht forma të larmishme të transmetimit të dijeve; leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit, praktikat profesionale, orët e hapura. (<i>Shtojca 3.18 Shembull i orëve të hapura</i>).
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Nga takimet me personelin akademik evidentohet përfshirja e një numri të konsiderueshëm të lëndëve e moduleve në planin mësimor (<i>Shtojca 2.7</i>), kjo tregon diversitetin e formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies; të gjitha lëndët e modulet përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, praktika mësimore, laboratorë, detyra dhe projekte kursi, praktika profesionale, etj. Rezulton se personeli akademik përshtatet dhe i përgjigjet plotësisht nevojave të studentëve, bazuar në prurjet periodike të çdo viti dhe prirjet individuale të tyre.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Mjediset e institucionit kanë <i>Wi-Fi</i> ; sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, postera informues, kanë sistem ngrohje, etj.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është	GVJ organizoj takime krahas GVB ashtu edhe me stafin akademik të DBK. Nga takimet dhe kontrolli i dokumentacionit

kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	u pa se personeli i DBK paraqitet me një shkallë të kënaqshme kualifikimi akademik dhe është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në disiplinat bazë: kimi dhe biologji (<i>Shtojca 4.1</i>).			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga intervistat e kryera rezultojnë se bashkëpunimi pedagog student përta i përket informimit mbi lëndën, udhëzimin mbi detyrat e pavarura, apo aspekteve të tjera në dobi të përmirësimit të procesit të mësimdhënies është plotësisht i realizuar. Konstatohet se studentët në mënyrë periodike plotësojnë pyetësorët e vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies (<i>Shtojca 3.13, Pyetësori studentor.pdf</i>) dhe (<i>Shtojca 3.14 Pyetësori i stafit akademik.pdf</i>).			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Metodat interaktive dhe diskutimi për ta bërë mësimin më tërheqës është pjesë interesante e diskutimeve me studentët. Ata pretendojnë se kanë atraksion kur mësimit shoqërohen me demonstrime, video, power point, animime të analizave kimike dhe biologjike dhe sidomos me laboratore konkrete. Studentët reflektojnë se orët e mësimit janë tërheqëse sidomos ato që lidhen me tema praktike dhe me tematika konkrete.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me studentët dhe sqarimet e GVB rezultojnë që: për të stimuluar punën e pavarur të studentëve dhe për të rritur nivelin e mësimdhënies prej tyre, në mënyrë graduale rritet pesha e detyrave dhe projekteve të kursit në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Studentët shprehin që puna për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit zë një kohë relativisht të gjatë, kërkohet edhe një angazhim i madh i tyre jashtë orarit mësimor. Studentët vlerësojnë punën në grup dhe sidomos edhe me pjesëmarrjen apo ndihmën e pedagogëve. Detyrat e kursit përgjithësisht mbetet një punë e pavarur dhe tërheqëse për studentët dhe rrit besimin e dyanshëm pedagog - student, krijon marrëdhënie profesionale midis tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimdhënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat	Duke shqyrtuar dokumentacionin mbi kapacitetet e UNIKO, si dhe Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane (<i>Shtojca 4.7,</i>

<p>janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p><i>Të dhënat infrastrukurore në funksion të programit të studimit.pdf</i>), por dhe nga vizitat në institucion, rezulton se DBK ka hapësirë të konsiderueshme për realizimin e procesit mësimor; Programi i studimit “Bachelor” në “Biologji-Kimi” realizohet në disa godina të UNIKO në varësi të infrastrukturës, e veçanërisht të laboratorëve. Nga vizita në godinën e Fakultetit u pa qartë që mjediset ishin të rikonstruara dhe me punime cilësore. Sipërfaqja në dispozicion të zhvillimit të programit mësimor përlllogaritet në 2.27 m²/student.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ u vu re që mjediset janë jo vetëm të mirëmbajtura dhe të pastra, por kanë të implemetuar masat sipas protokolleve anti Covid 19. Takimet u zhvilluan në salla duke ruajtur distancimin social si dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe dezinfektuese.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Gjithashtu, infrastruktura është në funksion në dispozicion të mësimimit dhe të mësimdhënies (<i>Shtojca 4.7, Të dhënat infrastrukurore në funksion të programit të studimit.pdf</i>). Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (tavolina, karrige, pajisje audiovizive, tabela për shkrim me lapustila, etj.) si edhe me videoprojektorë.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Realizimi i procesit mësimor mbështetet përmes infrastrukturës informatike dhe teknologjisë në Fakultet dhe në DBK, në aspektin organizativ dhe strukturor, përmes sistemit dhe faqes së internetit, ku realizohet mbështetja e të gjithë procesit nga hyrja e studentit deri në dalje. Infrastruktura ndikon drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies përmes laboratorëve kompjuterikë për të realizuar praktikat/seminaret në module të caktuara.</p> <p>E gjithë kjo infrastrukturë është në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve, që ofron shërbime të shumta dhe cilësore (korrespondencë elektronike, kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim online të rezultateve të vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar, komunikim elektronik pedagog - student). Sipas RVB dhe kontrollit direkt në system rezulton që; Sistemi i IT mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin (<i>Shtojca 1.6, Rregullore e esse 3.pdf</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në programin e studimit Biologji - Kimi është në gjuhën shqipe. 97% e lëndëve të formimit profesional mbështeten në tekste mësimore të botuara nga universitete të tjera kryesisht Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore. Vihet re që</p>

studimit.	literatura e cituar në fund të syllabuseve shpesh nuk ka të indikuar vitin e publikimit të saj. Nga takimi me stafin akademik si dhe studentët e DBK rezultoi se: krahas tekstit apo ciklit të leksioneve, çdo pedagog vendos leksionet e tij në Word dhe PowerPoint në website personal, si dhe ja dërgon me e-mail (ose duke përdorur aplikacione të tjera) studentëve përkatës. Literatura shtesë që rekomandohet përzgjidhet midis titujve më të spikatur në fushën përkatëse, kryesisht në gjuhën angleze. (Shtojca 2.5).
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi që: Biblioteka Shkencore e UNIKO ka rreth 1100 anëtarëve (pedagogë, studentë, administratë dhe punonjës të jashtëm), një pjesë e mire e të cilëve i përkasin FSHNH. Biblioteka e FSHNH ka një fond prej rreth 10592 libra e revista, me rreth 1031 tituj, të cilat shfrytëzohen nga studentët e pedagogët e fakultetit. Rreth 1544 libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohen në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht e italisht) dhe rreth 9048 mijë, në gjuhën shqipe. (Shtojca 4.10, Të dhëna nga fondi i bibliotekës në funksion të programit të studimit.pdf). Edhe nga ky dokument konstatohet që mungojnë vitet e botimit të librave, gjë që do ishte orientuese për studentët dhe stafin akademik për të punuar me literaturë sa më të përditësuar.</p> <p>Gjithashtu në fakultet funksionon dhe Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond të specializuar librash dhe revistash në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies në shqip e gjuhë të huaja. Biblioteka e Qendrës së Ekselencës ka një fond 190 tituj (shqip) 490 tituj (gjuhë të huaj). (Shtojca 4.10). Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte 8.00–16.00, orararet e saj janë publike dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të DBK rezultoi se: Burimi kryesor i informacionit janë on line në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve të UNIKO është prej vitesh një librari digjitale që mundëson aksesimin online të revistave shkencore. Libraria është e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët nga burime të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në vizitën e bërë direkt në Fakultet si edhe në Departamentin e Biologji-Kimisë bie në sy infrastruktura laboratorike. DBK ka 2 laboratorë (Laboratori i Biologjisë dhe Laboratori i Kimisë Inorganike dhe Analitike). Laboratorët janë funksionale dhe në vizitën që u bë në to ishin të pranishëm edhe studentët.</p> <p>Në laboratorët në fjalë ka një infrastrukturë të kënaqshme si dhe</p>

	<p>pajisjet bazë dhe reagentë të bollshëm për eksperimentet e kimisë, gjë që bën të mundur realizimin e programit mësimor, si dhe programit studimor për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale të studentëve për tezat e diplomave. Në funksion të programit të studimit janë gjithashtu edhe 5 laboratorë, pjesë e departamenteve të tjera: Laboratori i anatomo-fiziologjisë, Laboratori i mikrobiologjisë, Laboratori i metodave të analizave instrumentale, Laboratori i informatikes, Laboratori i fizikës. (<i>Shtojca 4.7, Të dhënat infrastrukurore në funksion të programit të studimit.pdf</i>).</p> <p>Sipas bisedave direkt me stafin akademik dhe studentët rezultoi që laboratorët shfrytëzohen në mënyrë të vazhdueshme nga studentët dhe pedagogët. Në laboratorin e biologjisë vihet re që aty ka shumë materiale didaktike të mbledhura në natyrë dhe përgatitura për ruajtje afatgjatë nga vetë studentët.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Format e mësimimit online (e-learning) të përdorura si dhe të linkuara në websitin e fakultetit janë: <i>Google Classroom, Google Meet, eduMEET, Moodle</i>, etj.</p> <p>Platforma <i>Moodle</i> nuk është aktive.</p> <p>RVB si edhe Stafi IT pohon se nëpërmjet projektit për instalimin e platformës OFFICE 365 (<i>Shtojca 3.16, Model mësimi online.pdf</i>) janë marrë masat që për vitin e ri akademik të zbatohet kjo platformë.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Takimet me IT e Universitetit, stafin akademik të departamentit si dhe studentët rezultoi se semestri i dytë i vitit akademik që përfundoi është zhvilluar totalisht online për shkak të pandemisë Covid-19. Studentët dhe personeli akademik shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Nga intervistat me studentët e programit “Bachelor” në “Biologji-Kimi”, përgjithësisht përfundon me provim formimi. Janë të pakët (në periudhën dhe kontaktet me studentët në takim) vetëm një ishte përzgjedhur për temë diplome. Departamenti përcakton kriteret dhe standardet e përgatitjes së një punimi diplome. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Fushat e temave të diplomave janë të percaktuara në Regulloret e studimit, si dhe në manualet e punimit të diplomave (<i>Shtojca 2.14, Manual për punimin e diplomës.pdf</i>) (<i>Shtojca 2.5, Rregullorja e programit të studimit bachelor në biologji kimi</i>). Departamenti ka në dispozicion të realizimit të temave të diplomave edhe infrastrukturë laboratorike duke përfshirë edhe reagentët.</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Nga takimet dhe dokumentacioni në dispozicion rezultoi që; UNIKO në nivel institucional ka struktura të organizuara në mënyrë që të promovojnë mësimdhënien si edhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Këto struktura të posaçme bëjnë të mundur dhe monitorojnë procesin mësimor. Në nivel institucioni funksionon “Sektori Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë” (SKSC) në varësi të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (<i>Shtojca 1.5. Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (njsbc, qka).pdf</i>).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	SKSC menaxhon veprimtarinë e Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Në nivel fakulteti, njëri nga zëvendës dekanët është përgjegjës për ecurinë e procesit mësimor dhe garantimin e cilësisë së tij. Vetë departamenti luan një rol të rëndësishëm për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë e programeve të studimit që ofron.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nga vizita në nivel institucional, na rezultoi se cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme. Këto struktura mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Për vetë faktin që departamenti është relativisht i ri kualifikimi i stafit akademik është një nga prioritetet e tij. UNIKO nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime me qëllim zhvillimin dhe integrimin e aftësive të tyre. Personeli akademik i përfshirë rezulton të jetë i kualifikuar (<i>Shtojca 4.1. Tabela e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.pdf</i>). Nga takimet me personelin akademik ata shprehen se bëjnë përpjekjet maksimale për tu kualifikuar dhe se për publikimet në revista prestigjioze ju nevojitet një nivel më i lartë pune dhe një mbështetje më e madhe institucionale.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë	Personeli akademik u shpreh se i kushton vëmendje të

përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	vazhdueshme rinovimit të leksioneve, teksteve dhe materialeve të tjera mësimore për të përfshirë në ato zhvillimet më të fundit të arritjeve të kërkimit në fushat e biologjisë dhe kimisë, të cilat i shërbejnë këtij qëllimi. Siç u përmend edhe më sipër; fondet për studime të avancuara kërkimore e shkencore në UNIKO janë të kufizuara. Stafi pedagogjik bën kujdes të përfshijë në projektet e kërkimit shkencor që financohen nga donatorë të ndryshëm edhe studentët.								
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë tërësisht përgjegjës dhe të angazhuar në programin e studimit. Vihet re një tendencë pozitive në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies si dhe implementimin e metodave të reja. Periudha e pandemisë ka kaluar mësimin online me metodat e cituara më sipër.								
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në lidhje me testimin e metodave të reja nga GVB u theksua se po tentohet të aplikohen metodat e laboratorëve virtualë. Kjo njihet si një metodë shumë efikase dhe alternative sidomos në laboratorët e kimisë dhe biologjisë ku reagentët janë jo vetëm të kushtueshëm por ekspozimi me to krijon probleme në shëndet dhe në mjedis. Studentët u shprehën pak të familjarizuar në këtë drejtim. Sa më sipër nevojitet që të bëhet më efektive dhe të raportohet në mënyrë që pritshmëritë të jenë të matshme.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>√</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			√	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		√							

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga intervistat me studentët rezultojnë se ata njoftohen që në momentin e parë që prezantohen me lëndën dhe pedagogët përgjegjës mbi ngarkesën javore dhe semestrale të saj, numrin e krediteve, shpërndarjen e të gjithë elementëve të programit të studimit dhe me mënyrën e vlerësimit të vazhduar (30%) dhe final (70%). Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore e Universitetit “Fan S. Noli” neni 82, 83 (<i>Shtojca 1.2</i>), Rregullorja e Programit të Studimit të ciklit të parë “Biologji-Kimi” (<i>Shtojca 2.5</i>) detajon kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve.

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët konfirmojnë se njoftohen në rastet kur lënda është e ndarë me module, të cilat mbulohen nga disa anëtarë të personelit akademik, si dhe në mënyrë të detajuar mbi metodologjinë e testimit, mënyrën e grumbullimit të pikëve brenda modulit, dhe shumën e pikëve të të gjitha moduleve deri në marrjen e vlerësimit final.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve siç u përmend më sipër ndahet në vlerësimin e vazhduar (deri në 30%) të totalit të pikëve dhe atë përfundimtar dhe realizohet në forma të shumëllojshme, përfshirë organizimin e seminareve, detyrave të ndërmjetme, ushtrimeve dhe punëve laboratorike, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, etj. Provimi përfundimtar zë deri në 70% të totalit të pikëve dhe realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe gojë cilësuar në çdo syllabus moduli.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Sipas (<i>Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Biologji - Kimi</i>); vlerësimi i studentëve ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit si seminare, laboratore, detyra kursi, teste paraprake etj. (30%), si dhe vlerësimi përfundimtar (70%) të pikëve i takojnë provimit final.</p> <p>Po sipas “Rregullores së Programit të Studimit”, raportet mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/ët në programin e modulit dhe ju bëhet e ditur studentëve me fillimin e modulit mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Grupi i vlerësimit e cilëson efektiv aplikimin e platformës ESSE 3. Çdo student ka llogarinë e tij elektronike, ku njihet me rezultatet e provimeve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit.</p> <p>Platforma ESSE 3 gjithashtu shërben si një skedar elektronik mjaft efektiv dhe i sigurtë për vlerësimet e studentëve ndër vite.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i</p>	<p>Nga diskutimi me stafin akademik për mënyrët e përdorimit të</p>




<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>sistemit si dhe vlerësimin e studentëve rezultoi se vlerësimi i njohurive gjatë vitit hidhet në sistemin ESSE3 dhe historiku i tyre ruhet nga sistemi për t'u konsideruar nga pedagogu edhe për sezonet e tjera kur studenti është ngelës në sezonin normal të modulit. Provimi pas përfundimit të lëndës bëhet nga komisioni i provimit që përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit. Në përbërje të komisioneve janë minimalisht dy anëtarë.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të dijeve kur ai zhvillohet vetëm me shkrim bëhet në mënyrë anonime me kodifikim. Kjo nuk realizohet në rastet kur provimi është me shkrim dhe me gojë si dhe në rastet kur provimi bëhet vetëm me gojë.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studentët pohojnë se gjatë vlerësimit të vazhduar (30%), por dhe gjatë vlerësimit përfundimtar (me shkrim dhe me gojë) personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme bën sqarime të qarta në mënyrë që edhe vetë studenti të ndërgjegjësohet mbi arritjet momentale dhe të mund të përmirësohet në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Sa më sipër GVJ vëren që personeli akademik ka krijuar një sistem pune me studentët në mënyrë të tillë që të shmangen plagjiaturat gjatë detyrave të kursit duke i motivuar me ide të reja si dhe punë laboratorike të ndryshme. Po kështu kopjimi në provime ju bëhet e qartë që është i patolerueshëm nga personeli akademik.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 6 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti njihet me vlerësimin e tij nëpërmjet llogarisë së tij me mail. Fillimisht listohen pikët e vitit dhe më pas sipas rregullores, llojit të testimit të dijeve merr pikët e provimit përfundimtar si dhenotët korresponduese sipas tyre. Rregullorja e programit të studimit sqaron detajet. Studentët shprehen të njohur dhe kënaqur me sistemin e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas bisedave me studentët, si dhe stafin akademik për pjesën e Rregullores së programit të studimit për pjesën e lidhur me kërkesat dhe ankimimin rezultoi që studentët kanë të drejtë të ankohet në rast se ndaj tyre janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar. Studentët pretendojnë të kenë paraqitur ankimime me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se një javë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet dekanit të Fakultetit.</p>

	Dekani ka përcaktuar nëse ankimimi është i drejtë apo jo dhe ka marrë vendim brenda dy ditëve. Sipas rregullores (<i>Shtojca 2.5</i>), ky vendim është i formës së prerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ konstatoi se Programi i studimit “Biologji-Kimi”, garanton formimin e specialistëve me aftësi të mira teorike bazë si dhe profesionale, duke synuar në krijimin e një qëndrueshmërie dhe tradite pavarësisht faktit që programi është realtivisht i ri. Nga takimet dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky program studimi garanton përgatitjen e studentëve me informacionin themelor dhe specifik, si edhe mundëson formim bashkëkohor të studentëve. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që t’u ofrojë studentëve njohuri të qëndrueshme në shkencat teorike bazë, formim të gjerë në Shkencat e Natyrës dhe të thelluar në fushën e biologjisë dhe në fushën e kimisë. (<i>Sipas Shtojca 2.7. Plani mësimor i programit të studimit ba bk.pdf</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Mbështetur në kurrikulat egzistuese në grupi i vlerësimit konstaton se ky program studimi zhvillon module të thelluara në biologji dhe kimi, këto module paraprihen dhe shoqërohen edhe me moduleve (në vitin e parë dhe të dytë të studimeve) që kanë për mision të rrisin kapacitetet e studentëve në fushën e ndërveprimit social dhe komunikimit (përfshirë module të mësimin të gjuhës së huaj) dhe të zhvillojnë aftësitë e veçanta të studentëve në teknologjitë e informacionit. Sa më sipër pasqyrohet në; (<i>Shtojca 2.7. Plani mësimor i programit të studimit ba bk.pdf</i>).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimet me studentët si dhe nga (<i>Shtojca 3.17. Model analiza në përfundim të një moduli.pdf</i>), kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, mangësitë e vërejtjet, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo moduli/lënde nëpërmjet anketimit për çdo modul.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo	Studentët dhe personeli akademik pohojnë se midis tyre

<p>lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>zhvillohen biseda të hapura mbi pritshmëritë dhe realizimin e objektivave të lëndës. Studentët pohojnë se janë plotësisht të orientuar nga pedagogët e tyre për çështjet e mësimin, praktikave profesionale, detyrave të kursit, etj.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët pohojnë realizimin dhe informimin e vazhdueshëm mbi përparimet e shkencës nëpërmjet seminareve apo leksioneve të hapura. <i>(Shtojca 3.18. Shembull i orëve të hapura.pdf)</i>.</p> <p>Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane gjatë takimit pohon se ka qenë pjesë e programeve “Erasmus+” <i>(Shtojca 2.19. Mobilitete trajnime Erasmus +.pdf)</i>. Sa më sipër ata theksojnë faktin që kanë sjellë eksperiencat më të mira dhe tentojnë të përdorin teknika inovative që aplikohen në universitetet e Rajonit të Ballkanit dhe si edhe Evropës. Ata mendojnë se kjo ka qenë një bazë shumë e mirë në realizimin e leksioneve të hapura. Sipas GVB edhe personeli akademik i ri ka marrë pjesë në orë mësimore që zhvillojnë pedagogët më me përvojë, me qëllim që të përfitojnë dhe transferojnë përvojën e tyre, si dhe të sigurojnë garantimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit <i>(Shtojca 2.9. Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në program BA bk.pdf)</i> rezulton se personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi është i kualifikuar, gjë që rrit mundësinë e transmetimit të dijeve dhe përgatitjen e specialistëve me kompetenca të kënaqshme në këtë drejtim. Sa më sipër shihet edhe në: <i>(Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR.pdf)</i>.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga intervistat me studentët ata dëshmojnë se personeli akademik ndihmon dhe mbështet punën në grup, duke nxitur jo vetëm debatin, por dhe diskutimin e gjerë për dijet e marra. Sa më sipër shihet edhe në faktin që një pjesë e mirë e detyrave të kursit, nuk janë punë individuale e studentit, por janë të realizuar në grupe me disa studentë, ku secili mundohet të japë kontributin e tij.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga takimet studentët konfirmojnë se personeli akademik mbështet çdo ide personale apo në grup mbi realizimin e një detyrë kursi, praktike profesionale apo teme diplome të sugjeruar nga vetë studentët.</p>

<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Nga takimet rezulton se UNIKO mbështet dhe promovon idetë dhe praktikrat inovatore në fushat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe të përpunimit dhe shfrytëzimit të mbetjeve të ndryshme që dalin nga industrinë ushqimore, duke inkurajuar implementimin e praktikave të mira në çdo sektor të prodhimit, përpunimit të ushqimeve.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Grupi i vlerësimit konstaton se numri i mobiliteteve të studentëve është relativisht i vogël. UNIKO është partner në disa projekte Erasmus+, të cilat kanë mundësuar që studentë nga programi i studimit të ciklit të parë Biologji-Kimi të ndjekin një pjesë të studimeve të tyre në Universitetet e tjera partnere (1 student i programit “Biologji- Kimi” kanë qenë përfitues i drejtpërdrejtë i këtyre projekteve).</p> <p><i>Pra është vetëm një student, mund të themi se në këtë aspekt personeli akademik duhet të jetë më aktiv në aplikimin në projekte për të rritur mobilitetin e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			√	

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedura për dhënien e provimit final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve në programin e studimit “Biologji–Kimi” është përcaktuar në: “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane” (<i>Shtojca 2.2</i>), në Rregulloren e njësisë bazë (<i>Shtojca 2.3</i>) dhe në Rregulloren e programit të studimit (<i>Shtojca 2.5</i>). Nga intervistat me studentët dhe stafin e departamentit rezultoi se temat e diplomave janë shumë të pakta, pothuajse zhvillohet provim përpara komisionit.</p> <p>Pyetsori i provimit të diplomës (<i>Shtojca 2.15</i>) si dhe procedura bëhen publike në mjediset e fakultetit ashtu edhe ne website. Studentët shprehen të familjarizuar me to.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimi me Stafin akademik të Departamentit rezultoi që stafi përcakton listën e temave për diploma në fillim të semestrit të pestë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti (<i>Shtojca 2.5</i>). Gjithashtu stafi dhe studentët pohuan se ata janë të pajisur udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së</p>




	diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas takimeve me stafin akademik të departamentit si dhe dokumentat në dispozicion (<i>Shtojca 2.5</i>); studentët japin provimin e formimit përpara komisionit të përbërë nga 4 antarë, pedagogë në fushat kryesore të studimit si: anatomia, biologji qelizore, kimi e përgjithshme, mikrobiologji, biologji, botanikë, gjenetikë, etj. (<i>Shtojca 2.15</i>). Komisioni përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohet nga dekani i Fakultetit para fillimit të provimit të formimit.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Studentët pohojnë se atyre i vihet paraprakisht në dispozicion materiali me elementët që do të përfshihen në pyetjet e provimit final; ata në çdo kohë mund t'i drejtohen pedagogëve përkatës të lëndës/modulit për paqartësitë që kanë.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	DBK i ka kapacitetet që t'ju ofrojë studentëve kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në (<i>Shtojca 2.14</i>) jepet manuali për punimin e diplomës, si dokument bazë për shkrimin e temës. Megjithë dokumentacionin në dispozicion si dhe interesimin për zhvillimin e temave, në DBK në programin e studimit “Biologji - Kimi”, sipas pohimit të stafit akademik është zhvilluar vetëm një temë diplome. Sa më sipër duhet të jetë në konsideratë të stafit akademik të departamenti për arsyen se ekziston e gjithë infrastruktura dhe laboratorët (sidomos në drejtimin e kimisë) për të zhvilluar analiza për temën e diplomës.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Gjatë intervistave nga GVJ, studentët pohojnë se ato vlerësohen me notë në përfundim të provimit final se mbrojtjes së diplomës. Sa më sipër është në komplaincë me Rregulloren e programit të studimit “Biologji - Kimi” si dhe me rregulloren e Fakultetit.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Nga dokumentat e vëna në dispozicion (<i>Shtojca 2.6</i>) jep modelin e diplomës/suplementit të programit të studimit. Suplementi jep në mënyrë të detajuar edhe numrin e krediteve si dhe informacion plotësues edhe në gjuhën angleze.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe intervistat e studentëve rezultoi se: Bashkë me diplomën dhe aneksin e saj, studentëve ju vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit “Biologji - Kimi”.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	GVJ bëri vizitë në sekretarinë e fakultetit dhe hallkat përkatëse të ruajtjes dhe depozitimit të dokumentave të studentëve. UNIKO dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. Regjistri i

	<p>lëshimit të diplomave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njehsuar me origjinalin ruhet për një kohë të pacaktuar.</p> <p>Theksojmë se ky informacion ruhet në hard copy (regjistrin themeltar), si dhe databazën digjitale sistemi ESSE3.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Programi i studimit realizohet nga pesonel akademik me kohë të plotë. Personeli akademik me kontratë angazhohet në rastet e zëvendësimeve gjatë mungesave me arsye.</p> <p>Gjarë vizitës në IAL GVJ realizoi një takim në zyrën e burimeve njerëzore në të cilën njoh me dosjet e stafit akademik dhe me kontratat e punësimit të tyre (<i>Shtojcat Model kontrate. Takim ZBNJ</i>)</p> <p>Institucioni ruan dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kontratë në përputhje me legjislacionin (<i>Shtojcat 1.14; 2.7; 2.9; 2.16; Takim, me ZBNJ</i>).</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ kreu takime me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore (ZBNJ) pranë Rektoratit të Universitetit "Fan Noli", Korçë, ku u njoh me procedurën e rekrutimit të personelit akademik të ftuar, e cila është e hapur dhe transparente, sipas rregullores së rekrutimit (<i>Shtojca. 1.13; Takimi, ZBNJ</i>). Procedura e rekrutimit është paraqitur e detajuar në RVB (<i>RVB Fq 37</i>), si dhe konfirmohet nga takimet e kryera midis GVJ dhe ZBNJ.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Referuar GVB, si dhe takimit me përfaqësues të ZBNJ, GVJ konstaton se institucioni bën publike kërkesën për vendin e punës, në përputhje me propozimet e ardhura nga Departamenti, Dekanati dhe miratuar nga titullari IAL.</p> <p>Procedura administrohet nga Drejtoria e Burimeve njerëzore Komunikimit dhe Promocionit, në përputhje me rregulloren (RVB i referohet <i>Shtojca 1.4</i>). GVJ evidenton që në këtë rregullore (<i>Shtojca 1.4</i>), nuk është referuar qartë se si ZBNJ administron procesin e rekrutimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>IAL ka një udhëzim mbi rekrutimin e stafit akademik (<i>Shtojca 1.13</i>), ku tregohen kriteret për përzgjedhjen e personelit akademik. Procedura e rekrutimit realizohet nga ZBNJ dhe behet publike në Bulletin e Njoftimeve Publike dhe në web. Kriteret për stafin që do të rektutohet janë specifike për vendin vakant, ku theksi kryesor është vënë në kualifikimin me tituj/grada të kandidatit.</p> <p>Procedura është e qartë dhe transparente.</p>			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




standardit				√
------------	--	--	--	---

Standardi IV.2				
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës GVJ u njoh me mjediset epunës, laboratorët, bibliotekën, sallat e leksioneve, seminareve dhe konstatoi se Universiteti "Fan Noli" e ka prioritet krijimin e mjediseve dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit. Çdo anëtar i personelit ka zyrëntë paisur me të gjitha mjetet e e nevojshme për zhvillimin e detyrave. Sistemi i internetit me kabëll apo edhe në formën <i>wireless</i> në ambientet e Fakultetit, lehtëson dhe përmirëson preçesin mësimor			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	UNIKO është i angazhuar në kualifikimin e vazhduar të stafit. Departamenti ka përgatitur një raport " <i>Mbi pjesëmarrjen e personelit akademik në programet që mbështeten nga Bashkimi Europian, si dhe i shkëmbimeve të ekspeiencae të ndryshme si në rastin e programit Erasmus</i> " (Shtojca 2.19). Gjatë takimeve me personelin akademik që përfshihet në zhvillimin e programit "Biologji Kimi" dëgjuam shembuj të kualifikimeve të stafit në kuadër të programeve të ndryshme, kryesisht Erasmus në universitetet të tjera partnere. UNIKO është i përfshirë në 6 projekte Erasmus "Capacity building" të cilat janë në proçes, si dhe 4 projekte që pritet të fillojnë rishtazi (<i>Takim me përfaqësues të zyrës së projekteve dhe mardhënieve me jashtë</i>). Stafi akademik është përfshirë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (Shtojcat 2.9 dhe 4.8)			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Personeli akademik është i aftë në përdorimin e teknologjive dhe metodave inovative. UNIKO ka krijuar infrastrukturën e përshtatshme (si videoprojektorë, praninë e internetit në të gjitha ambientet, bibliotekën etj) në funksion të proçesit mësimor. <i>Megjithatë GVJ konstaton se në RVB nuk janë dhënë metodat inovative që përdoren në proçesin mësimor.</i>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Stafi i Departamentit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor "Biologji Kimi" përbëhet nga 7 anëtarë, ku dy janë të kategorisë Master i Shkencave dhe 5 me gradën Doktor (Shtojca 4.8). Asnjë anëtar i stafit akademik nuk i përket kategorisë "Profesor". Në këtë drejtim Departamenti duhet të punojë fort për promovimin e stafit akademik, për përftimin e gradave dhe titujve akademikë			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet plotësisht

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	
			√	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Programi mësimor Bachelor në "Biologji Kimi" realizohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNNH). Auditorët e leksioneve kanë kapacitet 60 - 120 studentë, kurse auditorët e seminareve kanë kapacitet për rreth 40 studentë.</p> <p>GVJ vizitoi ambientet dhe konstatoi se ato janë të paisur me mjetet e nevojshme audio vizive, lidhje me internet, duke garantuar kështu infrastrukturën e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor në kushte optimale.</p> <p>Departamenti ka në funksion të programit mësimor dy laboratorë të natyrës didaktike dhe për punë kërkimore me infrastrukturë moderne. (Laboratori i Kimisë dhe Kimisë Analitike; si dhe Laboratori i Biologjisë dhe Biologjisë Molekulare) Në funksion të programit mësimor janë dhe 5 laboratorë të tjerë që i përkasin departamenteve të tjera të Fakultetit (<i>Shtojca 4.7</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Më sipër u përmend se sallat e leksioneve dhe seminareve janë të paisura me mjete moderne elektronike dhe internet, duke mundësuar përdorimin e teknologjisë së informacionit. Laboratorët gjithashtu janë modernë.</p> <p>Për rrjedhojë mjediset janë të organizuara dhe të paisura në nivelin optimal, për zhvillimin e mësimin teorik dhe praktik në nivele të larta mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga vizita e kryer në ambientet e Departamentit, si dhe evidencat (<i>Shtojca 4.7</i>), GVJ konstatoi mjediset ku zhvillohet mësimi, apo seanca laboratorike plotësojnë kriteret për të zhvilluar një proces cilësor të mësimdhënies.</p> <p>Studentët kanë mundësi të zhvillojnë praktika në institucione të ndryshme private dhe publike, e zyrtarizuar kjo përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit (<i>Shtojca 2.10</i>). Gjithashtu GVJ zhvilloi një vizitë pranë fabrikës së Birrës "Korça" ku u njoh nga afër për mundësitë e praktikave që kryejnë studentët</p>

	pranë kësaj kompanie			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Në funksion të programit të studimit janë dhe laboratorët kompjuteikë me kapacitet prej 24 vende, të paisur me infrastrukturën e përshtatshme (kompjuterat, videoprojektorë etj, internet), si dhe me programe/software në funksion të procesit mësimor			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	GVJ konstatoi se institucioni ka kapacitetet e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave mësimore, profesionale, si dhe praktikave në terren. Në mbështetje të këtyre praktikave janë dhe kompanitë e ndryshme private dhe publike (<i>Shtojca 2.10</i>)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UNIKO disponon një bibliotekë e cila është në dispozicion dhe përdorshme nga gjithë stafi akademik dhe studentët e këtij Universiteti, për rrejdhojë dhe të programit të studimit BSc "Biologji Kimi". Studentët përveç literaturës mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës, jo thjesht për literaturën, por edhe për të studjuar. Ajo është e paisur me kompjuterat dhe paisje të tjera teknike, si fotokopje etj, internet si dhe me infrastrukturë komode për ta shfrytëzuar më së miri bibliotekën.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në funksion të studentëve është edhe Biblioteka e qendrës së ekselencës gjithashtu me infrastrukturë optimale dhe fond në dispozicion të procesit mësimor. (<i>Shtojca. 4.10</i>). Në dispozicion të studentëve është edhe biblioteka shkencore, pranë Rektoratit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e FSHNH ka një fond prej rreth 10592 libra e revista, me rreth 1031 tituj, të cilat shfrytëzohen nga student e pedagogët e Fakultetit. Rreth 1544 libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohen në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht e italisht) dhe rreth 9048 mijë, në gjuhën shqipe. Biblioteka është e paisur me të gjitha tekstet mësimore, në funksion të programit të studimit, si edhe me materiale të tjera shkencore, si revista, apo teza doktorature.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e Qendrës së Ekselencës ka një fond 190 tituj (shqip) 490
Kriteri 5. Institucioni duhet të	

hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	tituj (gjuhë të huaj) (<i>Shtojca 4.10</i>).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>Studentët për një periudhë rreth një vjeçare kanë përdorur bibliotekën digjitale ProQuest. UNIKO punon në mënyrë të vazhduar për zgjerimin e fondit të bibliotekës.</p> <p>Të drejtën për të qenë anëtar i bibliotekës e kanë studentët, personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ si dhe komuniteti, të cilët janë të paisur me kartela personale. Biblioteka gjatëditëvetëjavësëhtë e hapur dhe në dispozicion të lexuesve në orarin 8:00-16:00. Biblioteka shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programeve të studimit të ofruara nga UNIKO. Gjithashtu IAL, ka dhe bibliotekën digjitale në kuadër të marrëveshjes me RASH.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të riaktivizohet përdorimi i bibliotekave digjitale, psh ProQuest, si të kanë patur përvojë të mëparshme, ose të bibliotekave të tjera si EBSCO, TEAAL etj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UNIKO ka në përdorim sistemin ESSE3, në kuadër të marrëveshjes me RASH (<i>Shtojca 1.6.1</i>), përmes të cilit administrohet i gjithë informacioni për studentët, duke përfshirë dhe sekretarinë elektronike (<i>Shtojca 1.6</i>). Përmes aplikacionit ESSE 3 (<i>Shtojca 1., Fq 11</i>) përmbushen këto funksione:
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Regjistrimi (regjistrim i ri i studentëve, modifikim regjistrimi, grupim studentësh mbi bazë programi, modifikim grupimesh, transferim studentësh midis programeve të studimit, raportime të ndryshme)</p> <p>Taksa e studentëve (pagesa të ndryshme nga studentët; gjenerim i faturave dhe vërtetim i pagesave për kategori të ndryshme të studentëve; raportime mbi gjendjen e pagesave).</p> <p>Plani mësimor (publikim online i kurikulës së studimit; monitorim i planeve mësimore; regjistrim në sistem i stafit akademik dhe ndihmës akademik; raportime mbi ecurinë vendosja e lidhjes midis lëndëve dhe stafit akademik).</p>

	<p>Proçedurat akademike (regjistrim i lëndëve me tipare të ndryshme për çdo program; menaxhim i lëndëve dhe krediteve të tyre; menaxhim i notave për çdo lëndë; krijimi dhe modifikimi i departamenteve dhe klasave: krijimi dhe modifikimi i grupeve të studentëve; transferimi i studentëve në programe të ndryshme studimi)</p> <p>Provimet (menaxhimi i provimeve, notave dhe pikëve, vendosja e kriterëve për pjesëmarrje në provim, për kalimin e provimit dhe vitit akademik, i provimeve semestrale dhe vjetore etj).</p> <p>Sistemi i menaxhimit të mësimdhënies (libreza elektronike e studentit, lista e notave me elementë sigurie, menaxhimi i vlerësimit dhe sistemit të krediteve).</p> <p>Sekretaria e shërbimeve të drejtpërdrejta (online) ku studentët aksesojnë grafikun e provimeve, notat, lajmërimi të dërguara nga pedagogët apo departamenti, vërtetime etj.</p> <p>Raporte dhe statistika (të dhëna për regjistrin themeltar të studentëve; regjistrimi i studentëve hyrës, raporte mbi pagesat e studentëve etj).</p> <p>Siguria e të dhënave: konfidencialiteti (mirëbesimi), integrimi vlefshmëria (autenticiteti i vërtetësisë së informacionit); autorizimi; konfidencialiteti; integriteti dhe vlefshmëria.</p> <p>Siguria ku përfshihet aplikimi në desktop dhe komunikimi në sistem.</p>			
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi ESSE 3 ka një udhëzues për përdorimin e moduleve përkatëse (<i>Shtojca 1.6</i>). Ai siguron akses të dedikuar, por edhe të mbrojtur nga ndërhyrjet.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i informacionit ofron aplikacione të integruar me njeri tjetrin që mbështesin proçedurat e administrimit, mësimdhënies dhe vetëshërbimit nga ana e studentit. Studenti merr në kohë reale informacionin që i nevojitet, siç është përmendur më sipër.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, pedagogët dhe studentët përdorin masivisht GoogleClassroom, Google Meet, eduMEET, Moodle (<i>Shtojca 2.18</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionipërprograminestudimit “Biologji-Kimi” është i publikuar në faqen e internetit të UNIKO, nënfaqja e departamentit të Biologji-Kimisë, vetëm në gjuhën shqipe. Gjithashtu jepet dhe plani mësimor i këtij programi studimi. Gjithashtu mund të jepet një informacion më i plotë për programin e studimit në lidhje me Objektivat e programit të studimit, mundësitë e punësimit të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




standardit				√
------------	--	--	--	---

Standardi IV.6
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se buxheti i universitetit hartohet dhe miratohet duke filluar nga njësitë bazë, kryesore dhe ndihmëse të tij: Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Financiare, të cilat kanë rregulloret e tyre të funksionimit (Shtojcat 1.7; 1.8).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Institucioni vë vënë në dispozicion "Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit" (Shtojca 4.11), i cili është programi buxhetor vjetor dhe afatmesëm, 2021 - 2023, në relacionin shoqëruar jepet informacion i detajuar mbi të ardhurat nga burime të ndryshme si nga pronësia, shërbimet administrative, shërbimet për të tretët, tarifat e studimeve në ciklet e ndryshme etj; kërkesat buxhetore për vitin 2021. Këtu përfshihen kërkesa si financimi i burimeve njerëzore, bursa, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, pasurimin eliteraturës, printimit, publikimeve, kërkimin shkencor etj</p> <p>Në fakt në këtë dokumentacion nuk del buxheti i përcaktuar për programin e studimit dhe për departamentin që e ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UNIKO I nënshtrohet auditimit financiar që realizohet nga Auditimi I Brendshëm duke u bazuar në për caktimet e bëra në dokumentet e brendshme, si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku ky i fundit bën publike rezultatet e auditit financiar.</p> <p>Raportet e auditit shqyrohen në Rektorat dhe Këshillin e Administrimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>UNIKO ka në strukturën e tij dhe degën e auditit, e cila planifikon plane auditimi.</p> <p>Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e siguruar nga Institucioni, rezulton se raporti i veprimtarisë financiare diskutohet në organet kolegjiale dhe bëhet transparent për të gjithë stafin apo studentët e interesuar.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete</p>	




financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UNIKO ka të përcaktuara në statut, politikat dhe procedurat për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve (<i>Shtojca 1.1</i>), ku pranimi i studentëve kryhet mbi bazën e meritës, kuotave të përcaktuara, rëndësisë si dhe lëndëve me zgjedhje. Institucioni disponon një sërë tregulloresh si ajp e FSHNH (<i>Shtojca 2.2</i>), të sekretarisë mësimore (<i>Shtojca 1.10</i>), të programit të studimit "Biologji Kimi (<i>Shtojca 2.5</i>) përmes të cilave përcaktohet qartë: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ecuria e ciklit të plotë akademik të studentëve që ndjekin programin e studimit ➤ Rregullat e regjistrimit të studentëve ➤ Të tërheqjes së diplomës Në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues për përdorimin e sistemeve të ndryshme. Studentët informohen në mënyrë të barabartë për programet e studimit përmes faqes së internetit apo sistemit ESSE3. Institucioni i mbështet studentët hyrës me takime për t'i familjarizuar ata me mënyrën e organizimit të programit të studimit, shërbimet e ndryshme që ofrohen etj (<i>RVB, fq 46, takimi me studentët</i>). Gjithashtu, në mbështetje të studentëve janë pedagogu kujdestar, si dhe koordinatorët e programit të studimit (<i>Shtojca 2.11</i>) Rregulloret e cituara më sipër nuk përmbajn kriteret diskriminuese apo përjashtuese ndaj grupeve të caktuara të studentëve.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së	Kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve, procedurat e përparimit të studentëve gjatë kursit të studimit, kriteret

studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	dhe procedurat e transferimit të studimeve, njohjes së studimeve të mëparshme të plota apo të pjesëshëm, pasqyrohen në nenet përkatëse të rregulloreve rrespektive të sipërpërmendura.			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	UNIKO ndjek procedurat dhe informon palët e interesuara për të lehtësuar aplikimin e sistemit online të ministrisë, për maturën shtetërore, ku procesi i hyrjes menaxhohet nga Ministria e Arsimit nëpërmjet portalit të saj. Sistemi, siguron barazimidis studentëve, garanton konfidencialitet të informacionit, njoftime në kohë reale. Kriteret e pranimit të studentëve në UNIKO miratohen nga Senati Akademik (<i>Shtojca 3.9</i>),			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të MASR, të cilat miratohen nga Senati Akademik i UNIKO (<i>Shtojca 1.1</i>). GVB bën me dije se studimet në FSHNH mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërore, si dhe nga çdo shtetas i huaj i cili k anjohuri të gjuhës shqipe, të cilët duhet të kenë bërë ekuivalentime diplomës së fituar nga komisionet përkatës në MASR.			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UNIKO, FSHNH dhe departamenti I Biologji-Kimisë organizon një plan vizitash informuese, sipas një plani veprimi (<i>Shtojca 3.10</i>) në shkollat e mesme, shkollat profesionale në të gjithë rajonin, me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ndihmësakademik, me qëllim informimin sa më të qartë dhe të plotë për zgjedhjen që këta nxënës duhet të bëjnë për karrierën e tyre akademike (<i>Takimi me studentët</i>). Programi Biologji Kimi ka qenë edhe pjesë e fushatës informuese online, ku nën kujdesin e IT, përmes sistemit ESSE 3 pasqyrohet informacioni që duhet publikuar në internet. Aplikantët gjejnë informacione të nevojshme dhe në website e UNIKO, ku përfshihen edhe formula e përlllogaritjes së pikëve për maturantët që dëshirojnë të studjojnë pranë UNIKO.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e FSHNH (<i>Shtojca 2.2</i>), si dhe të UNIKO (<i>Shtojca 1.2</i>) përcaktohen qartë programet e studimit dhe organizimi i tyre; vlerësimi i dijeve; transferimi, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i moduleve. Gjithashtu, studenti informohet për kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, numrin e nevojshëm të kriterëve etj, të cilat publikohen përmes sistemit të informimit, faqes së Universitetit. Në ndihmë të studentëve është dhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nërregullorene FSHNH dhe rregulloren e departamentit (<i>Shtojcat 2.2; 2.3</i>) përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve. Kështu vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit, i cili përfaqëson 30% të vlerësimit total, si dhe vlersimi përfundimtar. Studentët informohen në kohë dhe parapërgatiten përmënyrë zhvillimit të provimit final për çdo modul (provime gojë, me shkrim, me gojë dhe meshkrim). Formate kontrollit të dijeve janë: testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave të kursit, ushtrimet, labororet, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtja e temave të diplomave, etj.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studenti informohet për sa më sipër përmes burimeve të ndryshme: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sistemit ESSE3 ➤ Programit të moduleve ➤ Komunikimit të pedagogut të modulit ➤ Portalit të UNIKO. Në rregulloren e programit të studimit, përcaktohen procedurat e provimit të formimit, bazuar në programin e provimit të formimit, i cili u vihet në dispozicion studentëve përmes sekretarive përkatëse, në fillim të vitit akademik. Studenti përgatitet për provimin e formimit, bazuar në fondin e pyetjeve dhe lëndëve që përfshihen në provim (<i>Shtojca 2.15</i>). Në rastet e mbrojtjes së temave, studentit i vjen në ndihmë "manuali për punimin e diplomës" (<i>Shtojca 2.14</i>), i cili është i vlefshëm për studentët e programit Bachelor, si dhe Master Profesional.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të	UNIKO realizon një proces komunikimi transparent dhe të vazhduar në lidhje me programet e studimit që ofton. Kjo realizohet përmes

posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	materialeve promovuese (fletëpalosje). Gjithashtu në dispozicion të maturantëve që zgjedhin të studiojnë pranë UNIKO vihen në dispozicion sekretaritë mësimore, Zyrën e Studentëve duke organizuar një sërë vizitash me grupe promovuese pranë departamentit të Biologji-Kimisë(<i>Shtojca 3.10, takimi me studentët</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	UNIKO informon studentët në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes rregulloreve të ndryshme, të Fakultetit, të Departamentit dhe Programit të studimit (<i>Shtojcat 2.2; 2.3; 2.5</i>)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Informacioni u bëhet i ditur përmes sistemit ESSE3, faqes së universitetit, komunikimit me pedagogët, komunikimit me email etj
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Gjatë vizitës pranë Departamentit Biologji Kimi, GVJ u informua për bashkëpunimin me kompani të ndryshme private dhe publike, ku studentët mund të kryejnë praktika profesionale dhe mësimore, mbështetur dhe nga marrëveshje bashkëpunimi (<i>Shtojca 2.10</i>). Praktikë e mirë ishte bashkëpunimi me Kompaninë, Birra "Korça", ku ishin punësuar mjaft studentët të diplomuar në programin e studimit "Biologji Kimi". Krahas hartimit të marrëveshjeve, <i>GVJ sugjeron, organizimin e panairit të karrierës, i cili do të ndihmonte edhe më shumë në kryerjen e praktikave profesionale, apo punësimin e studentëve.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor nëpërmjet orarit mësimor Studentët informohen për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor përmes sekretarive.
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet	Më sipër, në standardin IV.5.1&4, u shpjegua qartë se Institucioni

permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në marrjen e diplomës. Ky sistem menaxhimi ka të integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve. Sistemi ESSE 3 u mundëson studentëve informacion mbi procesin mësimor në mënyrë lehtësisht të aksesueshme, madje edhe në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi, të cilat mund të gjenden në disa dokumenta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Regjistri Themeltar i Studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UNIKO. ➤ Rregjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo studenti regjistruar në UNIKO, sipas programeve të studimit. ➤ Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, është dokumenti që vërteton diplomimin e tyre prej UNIKO. ➤ Regjistrat gjenden edhe në formë elektronike. ➤ Sekretaritetë mësimore garantojnë plotësimin në kohë dhe me cilësi të formularëve, përmbledhëseve, listave të notave të studentëve që diplomohen, etj
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>GVB deklaron se Institucioni disponon dokumentacion të plotë periodic në lidhje me statistikat vjetore të studentëve të regjistruar të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit. Dokumenti të cilit i referohet GVB (<i>Shtojca 4.4</i>) nuk përmban këtë informacion të plotë, por është një përmbledhje në vitet akademike 2016-2017; 2017 - 2018; 2018 - 2019; 2019 - 2020 me numrat e studentëve të pranuar, si dhe notën mesatare minimale e maksimale. Gjithashtu jepet informacion mbi numrin e të diplomuarve dhe notën mesatare të diplomimit.</p> <p><i>Sugjerojmë që ky dokumentacion duhet të jetë më i plotë, ku të jepen të dhëna me numrat e studentëve të larguar, studentët që e kanë</i></p>

	<i>frekuentuar, si dhe gjendja e matrikullimit të studentëve</i>			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	<p>Sekretaritetë mësimore plotësojnë evidenca standarte, që ruhet në sekretarinë mësimore. Fakulteti disponon regjistrin e arritjeve akademike dhe diplomave me të dhënat:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i diplomës ➤ Lista e notave <p>Këto të dhëna menaxhohen nga sistemi i brendshëm i informacionit të Sekretarisë së Fakultetit.</p> <p>Informacioni në lidhje me diplomimin, listen e notave dhe suplementin e diplomës ruhet në regjistrin e arritjeve akademike dhe atë të diplomave, i cili, në përfundim të diplomimit, depozitohet në Arkivën e Shtetit dhe një kopje e njëzuar meorigjinalin ruhet në arkivën e UNIKO</p>			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Sistemi ESSE3 shëben për ruajtjen e informacionit të studentëve ku mund të aksesohet në kohë reale. Ky informacion transmetohet vit pas viti deri në diplomimin e studentëve.</p> <p>Informacionin e lidhje me studentët ruhet dhe përpunohet nga Qendra e Karrierës dhe Alumni. Informacioni që arkivohet është isigurtë dhe i verifikueshëm nga persona të autorizuar, duke ndjekur rregullat dhe procedurat e përpunimit të informacionit.</p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>FSHNN harton raporte analitike periodike mbi profiling dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke i shoqëruar këto raporte me rekomandime dhe masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve për vitin e ardhshëm akademik. Këto raporte përmbledhen në raportin e analizës vjetore të UNIKO (<i>Shtojca 2.20</i>).</p> <p>Ky informacion është i aksesueshëm për të gjithë stafin akademik, pasi kalon miratimin në Rektorat. Gjithashtu Institucioni në çdo fillim vit përgatit dhe miraton një plan masash, mbi bazën e analizës së një viti më parë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>këshilluese sipas me ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, si dhe statutit të UNIKO. Studentët krijojnë këshillin studentor (<i>Shtojca 1.17</i>, takimi me studentët). Organet studentore janë në kontakt të vazhduar me autoritetet drejtuese të UNIKO dhe ndikojnë në vendimmarrje. Gjithashtu ata kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin Akademik, si dhe në Komisionet për Sigurimin e Cilësisë (<i>Shtojca 3.4</i>).</p> <p>Proçesi është transparent, i cili përfshin propozimet e kandidatëve, votimin dhe nxjerrjen e rezultateve. Studentët njoftohen për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve përmes tel apo email të depozituar pranë Sekretarisë së Fakultetit. Duke filluar nga viti 2019, në përputhje me Paktin për Universitetin kanë përfaqësuesin e zgjedhur prej tyre në Bordin e Administrimit.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë dhe përfaqësuesin e tyre në GVB.</p> <p>Gjatë takimit me studentët ata konfirmuan përfshirjen e tyre të organet kolegiale të UNIKO</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Raportin vjetor të aktivitetit akademik të cilin UNIKO e paraqet pranë MASR, e publikon dhe ua bën të ditur stafit akademik, si dhe studentëve, me qëllim përfshirjen e tyre në analizë.</p> <p>Programi i studimit organizohet duke marrë në konsideratë aftësitë e studentëve për të përvetësuar sa më mirë njohuritë. Vlerësimi i ngarkesës akademike të studentit bëhet mbi bazën e informacionit teorik dhe praktik. Ngarkesa është e shpërndarë në mënyrë uniforme në semestra gjatë ciklit të studimit.</p> <p>Më sipër është përmendur mënyra e vlerësimit të studentëve. Gjithashtu Departamenti mundohet të lehtësojë proçedurat e njohjes së plotë, ose të pjesshme të lëndëve që studentët mund të kenë realizuar në programe të mparshme (<i>Shtojca 2.5</i>), ose si rjedhojë e mobiliteteve në kuadër të Erasmus + (takimi me përfaqësues të Zyrës së Kurikulave; Zyrës së Projekteve). Po kështu Institucioni ka proçedura të mirëpërcaktuara</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në proçesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit e programeve të studimit. Departamenti kryen anketime të studentëve për marrjen e opinionit të tyre mbi ngarkesën akademike dhe mësimore. Gjithashtu në fund të çdo semestriapo parasezonitë provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi, si dhe pyetësori online për vlerësimin e aktivitetit mësimor kërkimor ku vlerësohet edhe puna e strukturave ndihmëse (<i>Shtojca 3.13; 3.17</i>).</p>




<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>UNIKO ka hartuar një sërë dokumentesh që mundësojnë sigurimine barazisë, vlerësimit dhe kontrollit, si regjistri fizik, pasqyra e vlerësimit të studentit, hedhja e të dhënave për vlerësimin e studentit në sistemin ESSE3, ku student para hyrjes në provim mund të shikojë vlerësimin gjatë vitit, procedura e ankimimit. Në rastet e ankimimit, procedura, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesa vetë studentëve që mbahet në Dekanat.</p> <p>Sistemi është i tillë që për çdo ndërhyrje lihet gjurmë për kohën, apo edhe numrin serial të kompjuterit ku është hedhur vlerësimi. Pas periudhës së parashikuar në rregullore, sistemi nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">√</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UNIKO mbështet studentët për të krijuar një karriere të suksesshme, duke krijuar mundësi për realizmin e praktikave,</p> <p>suksesshme, duke krijuar mundësi për realizmin e praktikave, trajnimeve të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, workshope, seminare, të lehtësojë kontaktin me tregun e punës, si edhe gjurmimin e ecurisë së tyre të mëtejshme. UNIKO disponon të dhëna statistikore për zhvillimin e provimit të shtetit (<i>Shtojca 4.13</i>), për periudhën 2017 - 2019, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i studentëve të regjistruar. ➤ Përqindja e kandidatëve që e kanë marrë provimin që herën e parë ➤ Përqindja e kandidatëve që e kanë marrë provimin herën e dytë ose të tretë <p>Përqindja e kandidatëve që nuk e kanë marrë provimin</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin</p>	<p>UNIKO ka njësinë e informimit të studentëve.</p> <p>Siç është përmendur më lart funksionon sistemi që garanton informacionin e nevojshëm për studentët.</p> <p>Vendimet e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, Rektorati</p>




mësimor dhe programin e studimit.	dhe Dekanati në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatete analizave të bëra, etj., u bëhen me dije studentëve në formatë ndryshme si takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të Universitetit, njoftimeve në faqen elektronike etj.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	UNIKO u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumni e cila ka ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UNIKO, me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në pesë vjet (<i>Shtojca 3.20</i>). QKAbashkëpunon me dekanatë dhe departamentet: <ul style="list-style-type: none"> ➤ për të hedhur informacion në databazën e të diplomuarve rishtas; ➤ për të grumbulluar informacion lidhur me kërkesat për punë dhe aktivitete të ndryshme që organizohen në bashkëpunim me bizneset dhe Drejtoritë Arsimore; ➤ bën të njohur informacionin që lidhet me aktivitetet, ofertat për sponsorizime për student e ekselencës. 			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Shtyllat e QKA janë shërbimi për maturantët, studentët dhe alumni QKA ofron një sërë shërbimesh, ku një ndër ta është "Rjeti Alumni" - krijimi dhe zhvillimi i mardhëneve me studentët që kanë përfunduar studimet pranë UNIKO.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për	UNIKO harton politikat dhe procedurat, Manualin e cilësisë (<i>Shtojca</i>

<p>Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>1.16), si dhe standartet për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>Shtojca 1.1; 12</i>), të cilat miratohen nga organet kolegjinale. Manuali miratohet nga Rektori.</p> <p>UNIKO ka hartuar një plan strategjik 4 vjeçar (<i>Shtojca 1.3</i>) ku përshkruhen politikat dhe praktikat që ndjek ky institucion</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UNIKO ka të ngritur Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (<i>Shtojca 1.5</i>), pjesë e të cilës është edhe Sektori I Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Ky sektor ka pjesë funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e përbërë nga koordinatorët e çdo njësie kryesore. Koordinatorët e njësisë kryesore zgjidhen pasi është ngritur Grupi i Vlerësimit të Brendshëm me përfaqësues nga secila njësi bazë e njësisë kryesore, si dhe një përfaqësues i studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si një organ kolegjal i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga të cilët katër janë përfaqësues të fakulteteve, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues i SKSC. Pranë çdo njësie kryesore ngrihet edhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me përfaqësim nga çdo njësi bazë dhe nga organizmat studentore.</p> <p>Departamenti i Biologji – Kimisë realizon analizën e ecurisë së procesit mësimor dhe kërkimor, duke evidentuar drejtimet kryesore që përfshijnë veprimtarinë akademike në lidhje me qëndrueshmërinë e programit të studimit, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përmirësimin e laboratorëve më pajisjet e nevojshme, përshtatshmërinë e rregullores së programit të studimit, ngarkesat mësimore dhe literaturën, drejtimet kryesore të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik, si dhe studentët si aktorë të rëndësishëm të proceseve të sipërpërmendura.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sektori i Kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë, monitoron analizat dhe vlerësimet proceseve akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve përkatëse. Gjithashtu, zyra përgatit në mënyrë të përvitshme analizën e veprimtarisë mësimore të Universitetit dhe ia referon atë Senatit Akademik.</p> <p>Nga këto analiza nxiren rekomandime dhe janë lënë detyra për procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies dhe janë propozuar masa përmirësuese.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik organizohet rishikim i periodik i programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij, ku fokusi kryesor janë elementëve përbërësitë moduleve, krediteve, bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, literature e përdorur, procedurat e kontrollit të dijeve/provimeve dhe analizës së rezultateve të kontrollit. Në këtë proces merren në konsideratë dhe mendimet e studentëve përmes anketimeve të tyre</p>

	<p>Departamenti në fund të çdo viti akademik kryen analizën e performancës akademik e të stafit bazuar në pyetësonin për vlerësimin e stafit që aplikohet në përfundim të semestrit (<i>Shtojca 3.14</i>). Departamenti zhvillon takime dhe ballafaqime me studentët për të tërhequr opinionet e tyre mbi cilësinë dhe mbi mundësitë e përmirësimit në të ardhmen.</p> <p>Departamenti përdor metoda të tërthorta vlerësimi si: pyetësoni i studentëve, pyetësoni i stafit akademik, sondazhet e studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike, apo në ciklet e ndryshme të studimeve si dhe sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, etj.</p> <p>Si shembull mund të merret anketimi i studentëve i vitit akademik 2017-2018 (<i>Shtojca 3.13</i>), në dy cikle të studimit, “Bachelor” dhe “Master ishkenca”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Në institucion ekzistojnë dhe janë funksionale njësi të posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Kështu, Sektori i Kurrikulave dhe Sigurisë është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit. Në këtë kuadër funksionon edhe NJSBC, e cila nëpërmjet kontolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, evidenton problematikat kryesore të lidhura kurrikulat.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se institucioni përdor procedura formale të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit, si dhe për mbikëqyrjen e here pas hershme të programeve të studimit. Nëpër fundim të vitit akademik, departamenti i Biologji- Kimisë rishikon programet e studimit dhe rregulloren mësimore dhe me synim rritjen e cilësisë, bën propozime për ndryshime për vitin e ardhshëm akademik, sipas një procedure të mirëpërcaktuar dhe evidentuar (<i>Shtojca 2.12</i>).
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë	Instrumentat e përdorur për vlerësimin e cilësisë janë përmendur dhe më sipër. Ato përfshijnë anketimet dhe pyetësonët e studentëve në

dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	përfundim të çdo semestri (<i>Shtojca 3.17</i>) për programin e studimit, për performancën e stafit akademik, etj			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe shfrytëzuara për ndryshimet në funksion të rritjes të cilësisë, ruhen pranë departamentit të Biologji-Kimisë dhe në arkivë. Raporti hartohet dhe shqyrtohet në të gjitha instancat deri në Senatën akademik ku edhe miratohet.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	FSHNNH çdo vit harton raporte të veprimtarisë institucionale, që përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor (<i>Shtojca 2.20</i>). Raportet përfshijnë rezultatet e vlerësimit dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	UNIKO ka të ngriturnjësinëe sigurimit të brendshëm të cilësisë, e cila në mënyrë periodike harton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm në rang Fakulteti (<i>Shtojca 3.7</i>) dhe IAL-je. Ky raport shërben si dokument bazë për vetëvlerësimin e programeve të studimit. Gjithashtu raportet e vlerësimit të brendshëm ishin pjesë e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të akreditimit institucional.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Departamenti i Biologji Kimisë përdor një sërë metodash dhe instrumentash për kryerjen e vlerësimit: Vlerësimi periodic të kurrikulës së programit të studimit dhe kur është gjykuar e nevojshme janë bërë ndryshime (<i>Shtojca 2.12</i>). Vlerësimin paralel të provimeve të studentëve në rastet kur ka ankimum nga ana e studentit për vlerësimin e provimit. Përgjegjësi i njësisë bazë realizon vëzhgime gjatë realizimit të procesit mësimor, kryesisht gjatë zhvillimit të praktika venë terren dhe atyre mësimore. Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, realizon pyetësorë, ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen etij, etj. (<i>Shtojca 3.17</i>). Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të ndryshme të realizuara nga Qendra e Karrierës dhe Alumni, apo nga

	punë dhënë të ndryshëm (<i>Shtojca 3.20</i>).			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Ddepartamenti Biologji-Kimisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Harton në mënyrë periodike raporte të analizës së mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore (<i>Shtojca 3.8</i>). • Organizon vazhdimisht orë të hapura me <ul style="list-style-type: none"> ➤ Studentët që janë në proces studimi, ➤ Me ata që kanë mbyllur studimet pranë këtij Fakulteti, si dhe ➤ Me pale të tjera të interesuara rreth tematikës së orëve të hapura. <p>Këto shërbejnë për shkëmbimin e eksperiencave midis anëtarëve të departamentit, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies (<i>Shtojca 3.18</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>				
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukture të gjitha niveleve në UNIKO janë të përfshira në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, sipas përcaktimeve në rregulloret e FSHNH, DKSCSKSH dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë, (<i>Shtojcat 1.2;1.5; 1.16</i>). Kjo bazë ligjore, garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm (stafi akademik, ndihmës e studentet) pa dallime e diskriminime dhe në respekt të integritetit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin</p>	<p>Më sipër janë përmendur në detaje mënyrat e drejtpërdrejta apo të tërthorta që përdor institucioni për sigurimin e cilësisë</p>

me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Departamenti i Biologji-Kimisë paraqet raportin e analizës vjetore për procesin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore pranë njësisë kryesore. Më tej hartohet raporti në nivel fakulteti, i cili diskutohet dhe nga Asambleja Akadematike (<i>Shtojca 3.8</i>)			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Rrjeti i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UNIKO është strukturuar duke përbushur kërkesat ligjore dhe në përputhje me misionin e institucionit.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, DBK ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përbushjes së standardeve të cilësisë.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Të gjitha dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë (si Statuti i UNIKO, Rregullore e brendshme e FSHNH, Manuali i Sigurimit të Cilësisë (<i>Shtojcat 1.1;2.2; 1.16</i>) bëhen publike dhe janë të aksesueshme nga i gjithë stafi akademik dhe ai ndihmës akademik I UNIKO, përfshirë këtu edhe studentët.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Departamenti i Biologji-Kimisë diskuton dhe analizon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore, (<i>Shtojca 3.8</i>), ku në raportin e hartuar jepen edhe rekomandimet për sa i përket përmirësimit të cilësisë
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Studentët, stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, informohen dhe ndërgjegjësohen në mënyrë të vazhduar për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë. Mbledhjet e departamentit, si dhe të Asamblesë Akadematike shërbejnë për njohjen me arritjet, mangësitë, problematikat dhe praktikatat lidhur me sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
“Biologji - Kimi” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Fan S.
Noli, Korçë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Personeli akademik i këtij programi studimi është i përkushtuar dhe i motivuar në realizimin e veprimtarive akademike të ndërthurura me formimin praktik të studentit.
2. Institucioni disponon kapacitete infrastrukturore në funksion të programit të studimit për realizimin me cilësi të procesit të mësimdhënies.
3. Laboratorët në funksion të programit të studimit janë funksionale, të mirë pajisur me aparatura dhe reagent për realizimin sa më të mirë të orëve laboratorike.
4. Programi i studimit është hapur si nevojë e tregut të punës dhe nevoja që ka rajoni Juglindor për mësues në fushë e Biologji – Kimisë.

Pika të dobëta:

1. Në programin e studimit Bachelor në “Biologji - Kimi”, jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve mbajnë titullin përkatës akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi.
2. Pjesëmarrja në projekte në fushën e biologjisë dhe të kimisë e departamentit dhe stafit akademik të programit është e ulët.
3. Nivele të ulta të kërkimit shkencor të stafit akademik dhe të rrjeteve brenda dhe jashtë vendit.

Rekomandime:

1. Institucioni, të përcaktojë e angazhojë si titullarë të lëndëve/moduleve të programit të studimit, pedagogë që mbajnë titullin përkatës, sipas përcaktimeve në aktet ligjore përkatëse.
2. Institucioni, të bëjë përpjekje për kualifikime të mëtejshme të stafit akademik me qëllim marrjen e titujve akademik Prof. dhe Prof.As.
3. Departamenti të bëjë përpjekje për të rritur numrin e aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, si dhe të kërkimit shkencor.
4. Institucioni, të rrisë mobilitetin e stafit akademik dhe të student me qëllim ndërkombëtarizimin e programit të studimit.
5. Departamenti, të nxisë dhe motivojë studentët e këtij programi studimi për të zhvilluar tema diplome.



Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Biology - Chemistry" of the "Fan. S. Noli" University, Korça

Strengths and affirmations:

1. The academic staff of this study program is dedicated and motivated in the realization of academic activities intertwined with the practical training of the student.
2. The institution has infrastructural capacities in function of the study program for the quality realization of the teaching process.
3. The laboratories in function of the study program are functional, well equipped with equipment and reagent for good realization of laboratory hours.
4. The study program is open as a labor market need and the need of the Southeast region for teachers in the field of Biology - Chemistry.

Weaknesses:

1. In the Bachelor study program in "Biology - Chemistry", not all course holders / modules hold the relevant academic title as defined in the legal acts.
2. Participation in projects in the field of biology and chemistry of the department and academic staff of the program is low.
3. Low levels of research of academic staff and networks at home and abroad.

Recommendations:

1. Institution, to define and engage as heads of subjects / modules of the study program, pedagogues who hold the respective title, according to the definitions in the relevant legal acts.
2. The institution should make further efforts for the qualification of the academic staff in order to obtain academic titles such as Prof. and Prof.As.
3. The Department should make efforts to increase the number of applications in national and international projects in the field of teaching as well as scientific research.
4. The institution should increase the mobility of academic and student staff in order to internationalize the study program.
5. The department should encourage and motivate the students of this study program to develop diploma topics.



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
“Biologji Kimi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Fan Noli”, Korçë**

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				√
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				√
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				√
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				√
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				√
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				√
VLERËSIMI TËRËSOR				√


